

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2021

SANKSIONET PENALE NDAJ TË MITURVE

Lindona Salihu

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)



Fakulteti Juridik

SANKSIONET PENALE NDAJ TË MITURVE

Shkalla Bachelor

Lindona Salihu

Prill/2021

Prishtinë



Fakulteti Juridik

Punim Diplome

Viti akademik 2015/2016

Lindona Salihu

SANKSIONET PENALE NDAJ TË MITURVE

Mentori: PhD Albulena Ukimeraj

Prill/2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesëshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Edhe pse delikuenca e të miturve ka ekzistuar që në kohët e hershme, mirëpo shkurt thënë nuk i është përkushtuar rëndësia aq e madhe. Në periudhën e fundit ky lloj kriminaliteti i të miturve sa vjen dhe rritet sidomos me zhvillimin e teknologjisë, ku në karakterin e fëmijëve dhe reagimin e tyre ndikojnë dhe kushtet e shumta që i posedojnë të miturit ditët e sodit dhe nga këta rrethana e faktorë është e dhimbshme të ndëgjohet shpesh herë që protagonist janë të miturit. Zbrazëtira të cilat do të mundohem që t'i plotësoj me anë të këtij punimi hulumtues - shkencor. Gjithsesi kjo kërkon një punë shumë më adekuate.

Kur një shtet do të posedoj një sistem qeverisës më adekuat, një ekonomi më të zhvilluar atëherë do të ketë ulje të shkallës së varfërisë dhe një kohësishtë do të kishim zvogëlim të delikuentëve të mitur që për mjerim si pasojë e këtyre shkaqeve të shumta plaçkisin pasuritë e huaja të paktën për të siguruar ekzistencën minimale për jetesë, sidomos atëherë kur bëhet fjalë për të mitur jetimë e pa përkujdesje prindërore.

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Me rastin e perfundimit të temës së diplomës ne nivelin Bachelor, kam kënaqesin të falenderoj të gjithë ata që më kanë mbeshtetur, më kanë ndimuar më të dhëna dhe më kanë udhëzuar për realizimin e këtij punimi.

Falenderoj të gjithë profesorët e Fakultetit Juridik në Universitetin për Biznes dhe Teknologji – UBT, sygjerimet e tyre i kam pasur orientim referim për punimin e temës së diplomës po edhe për gjatë 4 viteve të studimeve. Këshillat dhe mësimet e tyre do të jenë gjithmonë bazë referimi për tu ndjekur në jetë dhe karrierë.

Gjithashtu dua të falenderoj në veçanti udhëheqësen time shkencore Dr. Albulena Ukimeraj për ndihmën e madhe që më ka dhënë përmes sygjerimeve dhe vërejtjeve, për vëmendjen që më ka kushtuar dhe për korrektësinë e treguar gjatë studimeve në nivelin Bachelor në Fakultetin Juridik e veçanërisht gjatë punimit të kësaj teme, duke qenë një mbështetje e madhe për mua. Ajo ka qenë prezente në të gjitha fazat e punimit dhe më ka ndimuar vazhdimisht për të kaluar vështirësit që kam hasur duke më inkurajuar që të mos tërhiqem para vështirësive që kam hasuar gjatë punës dhe analizës në temë. Me të jam ndier e frymëzuar për të punuar dhe për ta përfunduar këtë punim diplome dhe për ta përmbyllur këtë cikël të rëndësishëm të studimeve.

Dhe së fundi por jo edhe nga rëndësia, dua ta falenderoj familjen time, për kurajon dhe për mbështetjen që më kanë ofruar gjatë rrugës së gjatë të arsimit. Pa mbështetjen e tyre une nuk do arrija ta përmbyllja këtë rrugëtim dhe do ju jem mirënjohese gjatë gjithë jetës prindërve, motrave dhe vëllaut, për kultivimin e dëshirës për të arritur qellimet e mia dhe të angazhohem për të përfunduar atë që kam filluar. Një falenderim i veçantë shkon edhe për miket e mia Agnesën dhe Diellzën, për mbështetjen e tyre në çdo kohë dhe miqësinë e pakushte që vazhdojnë të më ofrojnë si një ndër dhuratat më të mira që një njëri mund të ketë.

Faleminder

PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	1
2	SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	2
2.1	Kuptimi i sanksioneve penale	2
2.2	Delikuenca e të miturve.....	3
2.2.1	Kuptimi i termit delikuenc	3
2.3	Disa koncepte mbi kriminalitetin e të miturve	5
2.4	Trajtimi sociologjik i delikuencës së të miturve	5
2.4.1	Pikëpamjet sociologjike të Emil Dyrkemit.....	7
2.4.2	Pikëpamjet sociologjike të Franc Von Listit	7
2.5	Mendimet e shkollës së mbrojtjes së re shoqërore.....	7
2.6	Teoritë e reja sociologjike ose amerikane	8
2.7	Teoria e dezorganizimit shoqëror.....	8
2.8	Teoria e konflikteve dhe dallimeve kulturore	8
2.9	Teoria e anomisë	9
2.10	Teoritë e interaksionit dhe etiketimit	9
2.10.1	Teoritë e etiketimit (njollosjes).....	9
2.11	Trajtimi kriminologjik i delikuencës së të miturve	10
2.12	Trajtimi penalologjik i delikuencës së të miturve	11
2.13	ASPEKTE KRAHASIMIORE TË SISTEMIT TË SANKSIONEVE PENALE NDAJ TË MITURVE.....	12

2.13.1	Sistemi i sanksioneve penale ndaj të miturve në legjislacionin penal francez	12
2.13.2	Sistemi i sanksioneve penale ndaj të miturve në legjislacionin penal shqiptar	14
2.13.3	Sistemi i sanksioneve penale ndaj të miturve në legjislacionin penal kroat	14
2.14	Faktorët objektiv që ndikojnë në delikuencën e të miturve	17
2.14.1	Shkaqet ekonomiko – sociale.....	17
2.14.2	Faktorët subjektiv.....	25
2.14.3	Ndikimi i faktorëve socio-patologjik të kriminalitetit	28
2.15	REGJIMI JURIDIK I MASAVE DHE DËNIMEVE NDAJ TË MITURVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	32
2.15.1	MASAT E DIVERSITETIT	32
2.15.2	LLOJET E MASAVE DHE DËNIMEVE NDAJ TË MITURVE.....	33
2.15.3	Masat e zbatueshme ndaj të miturit	34
2.15.4	MASAT EDUKATIVE	36
2.15.5	Masat disiplinore.....	42
2.15.6	Masat institucionale	42
2.16	DËNIMET NDAJ TË MITURVE.....	44
2.16.1	Elementet e dënimeve ndaj të miturve.....	45
2.16.2	Karakteristikat e dënimeve ndaj të miturve	46
2.17	Dënimet plotësuese, dhe Masat e trajtimit të detyrueshëm.....	47
2.17.1	Dënimi me gjobë.....	48
2.17.2	Matja e dënimit me gjobë për të mitur.....	48
2.17.3	Urdhri për punë në dobi të përgjithshme	49
2.17.4	Burgimi për të mitur.....	49

2.18	Dënimet plotësuese ndaj të miturve	51
3	DEKLARIMI I PROBLEMIT	52
4	METODOLOGJIA	53
5	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	54
6	REFERENCAT	56

1 HYRJE

Ndaj kriminalitetit përgjithësisht, dhe kriminalitetit të të miturve nuk ka qenë imune asnjë shoqëri, pra as shoqëria kosovare. Si i tillë kriminaliteti ka qenë dhe do të jetë preokupim i shoqërisë njerëzore, përfshirë Kosovën edhe në të ardhmen. Një nga format e preokupimit të shoqërisë padyshim është edhe formësimi i reagimit ndaj tij. Reagimi i shoqërisë kosovare ndaj kryerësve të mitur të veprave penale me sanksione penale është madje shumë i hershëm. Reagimi i organizuar i shoqërisë kosovare ndaj kryerësve të mitur të veprave penale përmes sanksioneve penale ka kaluar nëpër faza të caktuara. Ky reagim është bërë duke ia përshtatur atë kohës, rrethanave shoqërore ekonomike, politike, juridike, kulturore, fetare etj. Sanksionet penale përgjithësisht, përfshirë sanksionet penale ndaj të miturve në sistemet juridike në përmasa shtetërore dhe ndërkombëtare, por edhe në Kosovë, përbëjnë pjesën më dinamike të zhvillimit të së drejtës penale. Sistemi i sanksioneve penale ndaj të miturve në të gjitha shtetet e botës, pra edhe në Kosovë është pikë qendrore e preokupimit të teorisë juridike penale dhe praktikës gjyqësore, por edhe çështje interesimi të organeve shtetërore dhe jo-shtetërore, opinionit të gjerë profesional dhe atij laik.

Në legjislacionin penal të Kosovës trajtimin të fëmijëve të cilët bien në konflikt me ligjin i kushtohet kujdes i posaçëm, duke miratuar një ligj të veçantë Kodin e drejtësisë për të mitur në vitin 2010, dispozitat e të cilit rregullojnë të gjitha çështjet e drejtësisë për të mitur. Kodi i drejtësisë rregullon trajtimin e të miturit si kryerës i veprës penale, fëmijës dhe të miturit si pjesëmarrës në procedurë, e cila bazohet në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke marrë parasysh interesat më të mira të të miturve, duke marrë parasysh pjekurinë e tyre, nivelin e zhvillimit, aftësive dhe veçorive personale, si dhe peshën e veprës, me qëllim të rehabilitimit dhe riintegrimin e të tyre shoqëror.

Kodi i Drejtësisë përcakton masat dhe dënimet të cilat mund t'i shqiptohen të miturve në konflikt me ligjin, të cilat janë edhe objekt i këtij punimi në veçanti masat e parapara ndaj të miturve. Në këtë punim është trajtuar disa çështje kryesore lidhur me këto masa ndaj të miturve si karakteristikat e këtyre masave, personat ndaj të cilëve mund të shqiptohen këto masa, kushtet të

cilat duhet të plotësohen për shqiptimin e këtyre masave, llojet e këtyre masave, organet përgjegjëse për caktimin e këtyre masave, dhe procedure e shqiptimit të tyre.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Kuptimi i sanksioneve penale

Sanksionet penale janë mjete juridike penale me të cilat realizohet funksioni mbrojtës i të drejtës penale, e që paraqesin bazën dhe qëllimin themelor të vetë ekzistimit të së drejtës penale. Të këtij karakteri janë edhe sanksionet penale ndaj të miturve. Sanksionet penale përgjithësisht, dhe sanksionet penale ndaj të miturve janë në epiqendër të vëmendjes të së drejtës penale dhe të politikës kriminale. (Salihu, 2008). Ato janë preokupim kryesor i të drejtës penale nga fakti se në të gjitha rastet kur personi i caktuar kryen vepër të rrezikshme, e cila është e kundërligjshme dhe e përcaktuar me ligj si vepër penale, është e domosdoshme që shoqëria ndaj kryerësit të veprës së tillë të ndërmarrë ndonjë masë, e cila ka për qëllim pengimin e kryerjes së veprës penale në të ardhmen. Në të drejtën penale masat që shqiptohen ndaj kryerësve të veprave penale quhen sanksione penale. (*Kodi Penal i Kosovës*)

Rrjedhimisht, sanksionet penale janë njëra prej instituteve më kryesore të së drejtës penale. Ato janë të ndërlidhura me të gjitha institutet tjera të së drejtës penale dhe reciprokisht plotësojnë njëra-tjetrën në sendërtimin e qëllimeve themelore të së drejtës penale. Në fakt, “Sanksionet penale janë pjesa më dinamike e të drejtës penale, që i nënshtrohen vlerësimit të opinionit të gjerë publik, profesional dhe shkencor, por edhe atij laik”. (Salihu, 2008) “Historiku i zhvillimit të së drejtës penale dhe sanksioneve penale paraqet historikun e civilizimit, nga se sanksionet penale paraqiten krahas paraqitjes së shoqërisë njerëzore”. (Garson, 1922). Kur e them këtë kam parasysh faktin se gjatë gjithë zhvillimit të shoqërisë njerëzore ka pasur sjellje, veprime të dëmshme dhe të ndaluara të individëve ndaj të cilëve, shoqëria e caktuar edhe me masa të caktuara represive (me sanksione penale) i ka luftuar këto sjellje të dëmshme. (Salihu, 2008) Vet historiku i zhvillimit të së drejtës penale nxjerr në pah të dhënën se në shek. e XX dhe në fillim të shek. XXI ndryshimet më të mëdha në të drejtën penale, në shumë sisteme juridike penale të botës, pra edhe në Kosovë janë

shfaqur pikërisht në sistemin e sanksioneve penale, përfshirë sanksionet penale ndaj të miturve. *(Salihu, 2008)*

Në kuadër të këtyre ndryshimeve janë hapur procese me rëndësi në tërë botën, por edhe në Kosovë. Këto procese kryesisht kanë të bëjnë me pluralizmin e sanksioneve penale, të cilat tani, por edhe në të ardhmen do të ndikojnë pashkëputshëm në vet karakterin e të drejtës penale. Me sanksione penale, përfshirë sanksionet penale ndaj të miturve duhet nënkuptuar njërën prej mjeteve të cilat i ndërmerr shoqëria, përkatësisht shteti për të mbrojtur personat, vlerat përgjithësisht, dhe shoqërinë nga kriminaliteti. *(Ukaj, 2006)*. Zhvillimi historik i shoqërisë njerëzore është përshkruar me llojllojshmëri të mjeteve e metodave të përdorura për luftimin e kriminalitetit. Është karakteristikë se në të kaluarën këto mjete kanë qenë shumë të vrazhda dhe qëllimi i tyre ka qenë hakmarrja ndaj kryerësit të veprës penale, kurse me kalimin e kohës ato kanë ardhur duke u harmanizuar, ashtu që qëllimi i tyre tani është mbrojtja e individit dhe shoqërisë nga kriminaliteti. *(Halili, 2006)*. Marrë në përgjithësi sanksionet penale paraqesin masa shtrënguese që zbatohen me dhunë dhe paraqesin represion ndaj kryerësit të veprës penale. Me anë të sanksioneve penale kryerësit të veprës penale i kufizohen apo i merren të drejtat, liritë dhe vlerat tjera shumë të rëndësishme, siç janë liria e lëvizjes, pasuria etj. Ndërsa, në disa vende ku akoma njihet si lloj i sanksionit dënimi me vdekje, kryerësit të veprës penale i merret edhe jeta. Së këndejmi, sanksionet penale, madje edhe ato ndër më të lehtat, në një masë janë një e keqe që e godasin personin që ka kryer veprë penale. *(Kodi i Drejtësisë për të Mitur)*

Sanksionet penale përgjithësisht, dhe sanksionet penale ndaj të miturve janë mjete ndëshkimore juridike penale dhe shtrënguese të përcaktuara me ligj, të cilat i shqipton gjykata në procedurë gjyqësore ndaj kryerësve të veprave penale, me qëllim të mbrojtjes së vlerave më vitale të individit dhe shoqërisë, e që kanë për efekt kufizimin ose heqjen e lirive dhe të drejtave të caktuara, ose paralajmërimin e mundësisë së heqjes ose kufizimit të tyre nëse përsëritet vepra penale.

2.2 Delikuenca e te miturve

2.2.1 Kuptimi i termit delikuenc

Shpeshherë, në jetën tonë të përditshme ne e dëgjojmë dhe e hasim termin “i mitur”, në aspektin letrar, gjuhësor, ligjor, psikologjik, etj. Nisur nga përkufizimet e mësipërme, sipas kontekstit në të cilin përdoret termi, për efekt të këtij punimi, termin “i mitur” ne do ta shohim në aspektin kriminologjik dhe në penalogji. Në aspektin gramatikor, i mitur konsiderohet personi që nuk ka arritur akoma moshën e pjekurisë, duke mos u bërë ende zot i vetes dhe i përgjegjshëm për veprimet e tij. Duke iu referuar nenit 1, të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, i mitur do të konsiderohet çdo fëmijë që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç (*Hajdari, 2008*). Ndërsa, duke i'u referuar përkufizimit të Ragip Halilit, mund të themi, se kriminelin i mitur është ai individ, që nuk ka mbushur moshën madhore të parashikuar nga ligji penal dhe kryen një vepër të dënueshme nga ligji (*Halili, 2010*). Termi Delikuencë (Devijim) rrjedh nga fjala latine “deliquare” që ka një kuptim shumë të gjerë, me këtë term kuptojmë përgjithësisht shprehjet, sjelljet dhe veprimet e përsëritura të të miturve që bien ndesh me moralin, zakonet dhe ligjet e mjedisit ku jetojnë. Shikuar historikisht delikuenca e të miturve është e vjetër sa edhe vetë njeriu dhe shoqëria. Pra delikuent quhet ai që ka sjellje të përsëritura devijuese, që bën vepra kriminale, duke shkelur kështu normat ligjore në fuqi (*Zejneli, 2008*).

Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar. Delikuenca gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë. Me delikuencë së të miturve nënkuptojmë sjelljet kundër shoqërore dhe kundër ligjore të personave të moshës së mitur (*Halili, 2008*).

Kjo lloj sjellje (delikuent) e të rinjve nuk paraqitet aty për aty, ajo fillon më herët të shfaqet në mënyrë më të lehtë por sjellja asociale fillon nga mosha e pubertetit 11-14 vjeç. Sjelljet asociale të fëmijëve në këtë moshë janë të shumta dhe të ndryshme. Mënyra e shfaqjes së sjelljeve asocial janë si kryeneçësi, fyerje dhe sharje, rrahje, mosbindje dhe mos durim, vjedhje, ikje nga shtëpia, ikje nga shkolla etj. Në qoftë se në këtë moshë nuk merren masa të duhura për mënjanimin e tyre, ato sjellje kanë rritje të vazhdueshme dhe fëmiju dalëngadalë do të merr epitetin e “fëmijë delikuent” (*Latifi, 1984*).

Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar. Delikuenca gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë. Me nocionin kryes i veprës penale nënkuptojmë kryerësit e mitur të veprave penale qofshin ata si kryerës, bashkë kryerës, nxitës apo ndihmës. Në të drejtën penale një kohë të gjatë mbisundon ideja se të miturit nuk duhet të ndahen prej kryerësve të rritur edhe pse në të drejtën romake ka ekzistuar dallimi i kryerësve sipas moshës. Ligji i XII tabelave për dy vepra, vjedhje publike dhe dëmtim të rendimenteve bujqësore për të mitur (impuberes), ka përcaktuar dënime të posaçme-rrahje, sipas vlerësimit të gjyqtarit dhe kompensim të dëmit. Por për herë të parë me kodifikimin e Justinianit është vendosur kufiri preciz ligjor mes të miturve (impuberes) dhe kryerësve të rritur (puberes) në katërbëdhjetë vjet për të mitur dhe në dymbëdhjetë vjet për të mitura. Ka ekzistuar sistem i vetëm i sanksioneve me atë që fëmijët e vegjël kanë qenë të “kursyer” nga zbatimi i dënimit, nëse gjyqi nuk konstaton se janë të dëmshëm (këqij). Kuptimi për të mitur atëherë si kriminel në miniaturë, prej të cilës rezultojnë edhe barazimet në trajtimin penalo-juridik, atëherë është mbështetur në maksimumen sunduese: militia supplet aetatem (të keqen e kompenson moshën)”(Salihu,2010).

2.3 Disa koncepte mbi kriminalitetin e të miturve

Nuk ekziston një përkufizim i pranuar në mënyrë konsensuale për sjelljen delikuyente të të miturve. Disa autorë e përkufizojnë delinkuencën si sjellje jo e ekuilibruar emocionalisht, të tjerë si sjellje antisociale e vazhdueshme, apo sjellje të përcaktuar si devijante nga autoritetet. Pavarësisht nga sa më sipër, delikuenca e të miturve dhe të rinjve është një status që përcaktohet nga gjykata mbi bazën e legjislacioni vendas, mbështetur në provat dhe të dhënat e grumbulluara. Sjelljet delikuyente të të miturve kanë dy dimensione të ndërthurura: të miturit si autorë të veprave penale dhe të miturit si të dëmtuar prej veprave penale.

2.4 Trajtimi sociologjik i delikuencës së të miturve

Kontributi i Sociologjisë së delikuencës së të miturve rezullton në rrjedhat e hulumtimeve të cilat janë parashtruar me forcën e argumenteve të arsyes dhe të aspekteve të tjera për hulumtimin e çështjeve sociologjike. Aspekti sociologjik i sjelljeve sociopatologjike dhe sjelljeve tjera të të miturve është i gjerë dhe kohëve të fundit shumë teorikë të disiplinave të shkencave humanitare, kanë pranuar aspektin sociologjik për këtë dukuri shoqërore (E. Elezi dhe V. Hysi, 2006). Sipas sociologëve, trajtimi i delikuencës së të miturve është i kushtëzuar me një studim shkencor kompleks të cilin gjithsesi duhet adaptuar duke bërë dallimin në kohë të caktuar dhe nëpër mjedise të caktuara. Aspekti sociologjik i sjelljeve socio patologjike dhe sjelljeve tjera të të miturve është i gjerë dhe kohëve të fundit shumë teorik të disiplinave të shkencave humanitare kanë pranuar aspektin sociologjik për këtë dukuri shoqërore. Sipas sociologëve, trajtimi i delikuencës së të miturve i kushtëzuar me një studim shkencor kompleks të cilin gjithsesi duhet adaptuar duke bërë dallimin në kohë të caktuar dhe nëpër mjedise të caktuara.

Koncepti kryesor dhe vendimtar në shkollën sociologjike është se faktori dominues në sjelljet e këtilla të të miturve gjendet jo vetëm në faktorin endogjen biopsikik, por edhe në faktorin shoqëror. Sipas kësaj, rëndësi të posaçme në shfaqjen e veprave penale nga ana e të miturve zënë faktorët e jashtëm veçanërisht faktorët shoqëror dhe rrethanat e tjera në të cilat kryerësi i veprave penale jeton dhe vepron. Disa nga faktorët janë: kushtet ekonomike, kushtet e jetës apo siç i quajnë disa autor kushtet banesore, familjare, mungesa e kontrollit të duhur nga ana e prindërve, përfshirja e të miturve në grupe të ndryshme etj. Kjo dukuri e rrezikshme shoqërore sot për shkak të aktualitetit dhe rëndësisë që ka, hyn në kategorinë e problemeve me përmasa botërore. *(Nasufi 2016)*

Aspekti sociologjik në të hulumtuarit e sjelljeve të delikuencës së të miturve, duhet të ndryshojë kushtet shoqërore të tyre, me shënime të sakta mbi rrethin familjar, shfrytëzimin e kohës së lirë, konsumimin e alkoolit, substancave narkotike, pjekurinë intelektuale etj. Edhe Hans Von Heting njëri prej teoricientëve më eminent në të kuptuarit dhe hetuarit e sjelljeve delikente, pikëpamjet e veta i ka mbështetur kryesisht në faktorët sociologjik, në të cilët tregon se ato sjellje janë gjithnjë të lidhura me shkaqet sociale dhe konstelacionin e faktorëve individual dhe atyre shoqëror.

2.4.1 Pikëpamjet sociologjike të Emil Dyrkemit

Në këtë drejtim janë të njohura veprat e tij “Vetëvrasja”, “Format elementare të jetës religjioze”, “Rregullat e metodës sociologjike” etj, lidhur me shkaqet e kriminalitetit thekson se krimi është dukuri normale e shoqërisë sepse ai është faktor i një ambienti të shëndosh dhe normal shoqërorë. Sipas tij shkaqet e krimit dhe rrënjët e tij gjenden në vet natyrën e shoqërisë njerëzore, në ambientin shoqëror dhe në mungesën e kontrollit shoqëror. Ai po ashtu thekson se shoqëria në të cilën ka rënë kriminaliteti ndodhet në një gjendje jo të shëndoshë dhe jonormale. Dyrkemi është i njohur me analizën e Anomisë që do të thotë gjendje pa ligj si faktor në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Ai Anomi e quan atë gjendje në shoqëri e cila cilësohet e paligjshme - kaos. Kjo gjendje është frika, pasiguria, izolimi, tërheqja në vetvete e individit ku manifestohet në qytete të mëdha në metropole që i quan kështjella të vetmisë. Idetë e Dyrkemit edhe sot janë aktuale në hulumtimet empirike kriminologjike.

2.4.2 Pikëpamjet sociologjike të Franc Von Listit

është i njohur si përfaqësues i shkollës sociologjike në të drejtën penale që e ka themeluar “Unionin ndërkombëtar për të drejtën penale”. Sipas Listit në paraqitjen e kriminalitetit ndikojnë 2 grupe faktorësh: Faktorët individualë - që mund të jenë të natyrës biologjike, psiqike dhe Faktorët social - që mund të jenë të natyrës ekonomike, familjare, sociale, politike etj. Faktorët social kanë ndikim dominant në krahasim me ata individual. Pastaj ai e bënë ndarjen në: kriminalitete akute dhe kronike. Kriminelët i ndanë në kriminel nga: shprehitë, tendenca, kronike, të përmirësueshëm, të pa përmirësueshëm.

2.5 Mendimet e shkollës së mbrojtjes së re shoqërore

Paraqiten pas Luftës së II-të Botërore, përfaqësuesit më të njohur të kësaj shkolle janë Filipo Gramatika & Mark Ansel. Kjo shkollë ka bërë hartimin e një aksioni antikriminel e cila ka pasur

për detyrë përmirësimin dhe kthimin e delikuentit në shoqëri dhe në fund mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti. Shkaqet e kriminalitetit kjo shkollë i gjenë në shoqëri dhe zakonisht janë të natyrës individuale dhe sociale. Ansel ka punuar në parandalimin e kriminalitetit në aspektin e përgjithshëm dhe individual, dhe dëmi nuk guxon të mbështet në hakmarrje. *(Nasufi 2016)*

2.6 Teoritë e reja sociologjike ose amerikane

pjesa më e madhe e këtyre teorive janë paraqitur në SHBA pas viteve 30'. Si teori të reja konsiderohen: Teoria e grupit ose sjelljeve devijante - që thekson se kriminaliteti është rezultat i ndarjes së shoqërisë në grupe të ndryshme, si në pikëpamje horizontale ashtu edhe në atë vertikale. *(Veseli, 1997)* Këto grupe mund të kenë karakter etnik, religjioz, kulturor, politik, racial e social. Sipas këtyre teorive kriminaliteti rrjedh për shkak të kundërthënive në mes grupeve të ndryshme. Prandaj sipas karakterit të këtyre grupeve shoqëria amerikane është teren i përshtatshëm për trajtimin dhe studimin e këtyre sjelljeve kriminale që paraqiten si rezultat i kundërthënive në mes grupeve të ndryshme. *(Latifi, 1997)*

2.7 Teoria e dezorganizimit shoqëror

Sipas kësaj teorie kriminaliteti është shprehje e një dezorganizimi që mbretëron në shoqëri. Si dezorganizim konsiderohet gjendja në ambiente shoqërore ku nuk është i pranishëm funksionimi normal dhe harmonik i të gjitha segmenteve të jetës politike, ekonomike, sociale dhe familjare. Dezorganizimi ç'rregullon jetën dhe punën e individëve, familjeve, grupeve të caktuara. Këtë koncept të paraqitjes të kriminalitetit e trajton dhe shpjegon Edhin Sutherland.

2.8 Teoria e konflikteve dhe dallimeve kulturore

potencon në konflikte kulturore ku qëndrimi ndaj kulturave tjera është negativ. Torsten konfliktet kulturore i ndan në konflikte primare që paraqiten atëherë kur ndeshen dy kultura, dy norma, dy vlera të grupeve dhe sistemeve të tyre dhe në konflikte sekondare që janë konfliktet kulturore që paraqiten brenda një grupi të së njëjtës culture *(Buletini Statistikor 2004 Bashkia Tiranë)*

2.9 Teoria e anomisë

Është paraqitur në Evropë e përkrahje ka gjet në SHBA, për herë të parë e ka përmendur dhe analizuar Dyrkemi e më pas e ka shtjelluar Robert Merton - i cili thekson se në paraqitjen e sjelljes kriminale ndikon gjendja e cila krijohet në shoqëri e sidomos kur shtresat e gjëra dhe të varura nuk arrijnë t'i realizojnë qëllimet e veta dhe arrihen moskuptime. *(Salihu, 2008)*. Meqë këto qëllime nuk arrihen në mënyrën e ligjshme atëherë disa individ e bëjnë këtë në mënyre të paligjshme me sjellje kriminale, kjo gjendje e shkeljes së ligjit dhe të pranisë së kaosit quhet gjendje e anomisë. Anomia është një gjendje e dëshirimit, e pasigurisë e sidomos gjendja e cila nuk siguron perspektivë për një numër të madh të individëve.

2.10 Teoritë e interaksionit dhe etiketimit

Teoritë e interaksionit kriminalitetin e shpjegojnë si rezultat i ndikimeve të disa faktorëve që vijnë nga vet organizmi i shoqërisë dhe pushtetit. Ato depërtojnë në kërkimet kriminologjike nga shkenca e psikologjisë dhe sociologjisë të cilat kanë gatuar traditë në aplikimin e kësaj teorie. Kjo teori e shpjegon kriminalitetin si pasojë të reagimit, aksionit, të organeve të ndjekjes, organeve të kontrollit të pushtetit dhe gjykatave. Becker ka thënë se sjellja devijante paraqet një kualitet e cila nuk qëndron në vet veprimet e individit por raportet e tij dhe shtetit që krijohen, pra në çdo shtet ekzistojnë grupe shoqërore të cilat kanë pushtet politik, ekonomik, pra, grupet konformiste. *(Salihu, 2008)*

2.10.1 Teoritë e etiketimit (njollosjes)

Shkaku i kriminalitetit kjo dukuri gjendet në praktikën dhe tendencën e regjimit, organeve të pushtetit që disa individ dhe disa grupe t'i etiketojnë e ti shpallin delikuent. Ky aktivitet i njollosjes quhet ndryshe stigmatizim, kur stigmatizohen personat dhe grupet tjera atëherë shpjegohen shkaqet e vërteta të sjelljes kriminale. Kështu nëse pushteti arrin që individëve t'i mvesh etiketën si kriminel pozita e tyre ndryshon dukshëm.

2.11 Trajtimi kriminologjik i delikuencës së të miturve

Në kriminologjinë moderne kohëve të fundit delikuenca e të miturve zë gjithnjë e më tepër vend me rëndësi dhe mund të thuhet se ajo ditë më ditë paraqet temë të kohës. Problemi parësor i kriminologjisë si shkencë është të gjejë shkaqet e sjelljeve kriminale të të miturve, pra të japë shpjegime etiologjike të delikuencës së të miturve si fenomen i posaçëm. Problem tjetër gjithashtu para së gjithash paraqet edhe ndriçimi i dukurive të ndryshme shoqërore, psikike dhe disa dukuri tjera që janë të lidhura me kriminalitetin. Që të arrije këtë qëllim kriminologjia si shkencë duhet ti analizojë më thellë proceset shoqërore në njërin anë dhe personalitetin e delinkuentit në anën tjetër. (Halili, 2012)

Gjatë shqyrtimit të kësaj teme shpesh kemi hasur në shënime që tregojnë jo vetëm për rritjen e këtij lloji të kriminalitetit por edhe për paraqitjen e formave të reja të delikuencës së të miturve. Për deri sa një kategori e autorëve mendojnë se kjo dukuri negative është prodhim i mos përmbushjes së nevojave të shoqërisë, kategoria tjetër mendojnë në personalitetin e të miturit. (Halili, 2012) .Autor dhe shkolla të ndryshme delikuencës së të miturve i japin rëndësi të madhe veçanërisht “faktorëve kriminogjenë” të cilët ndikojnë në format të ndryshme në paraqitjen e kësaj dukurie negative.

Sipas studimeve të shumta empirike faktorët që ndikojnë më së shumti në paraqitjen e delikuencës janë të shumta si p.sh.: faktorët ekonomikë, socialë, kulturorë etj. Nocioni kriminaliteti i të rinjve përdoret për të theksuar aktivitetin kriminal të të gjithë të miturve pa marrë parasysh moshën. Për arsye se ekziston një bindje se e gjithë popullata e re pa marr parasysh se në çfarë faze gjendet në pikëpamje biopsikike dhe socio kulturore ende nuk është formuar dhe se për këtë arsye ende është e nevojshme një qasje dhe trajtim i veçantë. Ky kuptim pak më i gjerë i delikuencës së të miturve më tepër gjen aplikim në trajtimet dhe studimet kriminologjike dhe sociologjike e më pak në ato juridiko penale sepse sipas konceptit juridiko-penal kjo çështje është rregulluar në mënyrë të saktë dhe konkrete me anë të dispozitave penale ku janë përcaktuar moshat dhe kategoritë e caktuara.(Halili, 2012)

2.12 Trajtimi penalogjik i delikuencës së të miturve

Në teorinë penalogjike dhe në praktikën ligjdhënëse bëhen përpjekje për përgatitjen e masave më adekuate për mbrojtjen e të miturve për pengimin e veprimtarisë së tyre delikuede dhe për riedukimin dhe risocializimin e tyre. Qëllimi i këtyre përpjekjeve dhe zgjidhja konkrete ligjore në shumë shtete, lidhur me këtë çështje është ofrimi, mbrojtja dhe ndihma e personave të mitur delikued duke ushtruar mbikëqyrje dhe kontroll ndaj tyre, duke i aftësuar ato gjatë qëndrimeve nëpër institucione të veçanta dhe duke zhvilluar përgjegjësinë e tyre personale që në të ardhmen të formohen dhe krijohen si qytetarë të ndershëm dhe korrekt. *(Ismaili, 2008)*

Masat edukative përmirësuese si sanksione të veçanta penale ndaj të miturve në radhë të parë kanë për qëllim pengimin e veprimit të delikuedëve të mitur por edhe riedukimin, risocializimin dhe përgatitjen e tyre për jetë. *(E. Elezi dhe V. Hysi, 2006)* Duke zbatuar këto masa, institucionet e ndryshme në shoqëri përpiqen të kenë një mbikëqyrje dhe kujdes më të madh në drejtim të rehabilitimit dhe riedukimit të personave të mitur të cilët kanë manifestuar sjellje dhe veprime të rrezikshme delikuede. Teoria bashkëkohore nisat nga koncepti se ndaj të miturve delikued duhet të aplikohen trajtime të posaçme dhe masa edukuese të cilat i përgjigjen personalitetit të të miturit të cilat janë adekuate nga ana pedagogjike dhe të cilat masa në një mënyrë do të ndikonin në rehabilitimin dhe riedukimin e të miturit delikued *(Zejneli, 2012)*

Qëllimi i përpjekjeve për pengimin e veprimtarisë së tyre delikuede dhe për riedukimin dhe risocializimin e tyre dhe zgjidhja konkrete ligjore në shumë shtete, lidhur me këtë çështje është ofrimi, mbrojtja dhe ndihma e personave të mitur delikued duke ushtruar mbikëqyrje dhe kontroll ndaj tyre, duke i aftësuar ato gjatë qëndrimeve nëpër institucione të veçanta dhe duke zhvilluar përgjegjësinë e tyre personale që në të ardhmen të formohen dhe krijohen si qytetarë të ndershëm dhe korrekt *(Halili, 2012)*

2.13 ASPEKTE KRAHASIMIORE TË SISTEMIT TË SANKSIONEVE PENALE NDAJ TË MITURVE

2.13.1 Sistemi i sanksioneve penale ndaj të miturve në legjislacionin penal francez

Në Francë sanksionet penale për të mitur në radhë të parë janë parashikuar me Kodin Penal të Francës. Ky Kod në nenin 122-8 të tij përcakton moshën për përgjegjësi penale. Zgjidhjet e parapara në këtë nen përcaktojnë se personi nën moshën 10 vjeçare është penalisht i papërgjegjshëm, megjithëse ai parasheh që ndaj tyre mund të zbatohen masat përkatës edukative. Kjo zgjidhje parimisht vlen edhe për personat nga mosha 10-13 vjeçare (*Stouthamer-Loeber, 2002*). Rrjedhimisht, në mënyrë më të detajuar çështja e sanksioneve penale ndaj të miturve në Francë është rregulluar me Kodin e Drejtësisë për të Mitur të Francës. Sipas këtyre dy Kodeve të miturit që kryejnë vepra penale nga mosha 13 deri në 16 vjeçare mund të gjobiten dhe ndaj tyre mund të caktohet paraburgimi si masë për sigurimin e prezencës së tyre në procedurë penale. Ndërsa ndaj të miturve që kanë moshën 16-18 vjeçare mund të shqiptohet edhe burgimi për të mitur. Pavarësisht zgjidhjes së përcaktuar, Kodet në fjalë e bëjnë më se të qartë faktin se ndaj të miturve prej moshës 13-18 vjeç gjatë shqiptimit të sanksioneve penale gjykata duhet t'u jap përparësi masave edukative (*Loeber, R. 1988*)

Dënimin me burgim të miturit gjykata kompetentë do t'ia shqiptoj atëherë kur konstaton se ai është i përgjegjshëm penalisht dhe kur ka kryer veprë penale të rëndë, dhe në rrethana rënduese. Këtë dënim, në rastet kur vepra penale është kryer në rrethana veçanërisht lehtësuese, sipas ligdhënësit francez mund ta shqiptoj në lartësinë e gjysmës së dënimin të parashikuar për veprën penale që është objekt gjykimi. (*Procedura penale-Komentar, Tiranë, 2003*), Me rastin e shqiptimit të këtij dënimi gjykata do të marr parasysh moshën e të miturit, pjekurinë psikologjike, karakterin dhe aftësitë, edukimin, mjedisin dhe rrethanat jetësore, arsyet dhe shkaqet e kryerjes së veprës penale, sjelljen e mëhershme të tij, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale etj. Ndaj të miturit gjykata kompetente mund të shqiptoj edhe urdhrin për punë në dobi të përgjithshme (komunitet), sidomos kur ai ka kryer veprë penale të lehtë dhe në rrethana lehtësuese. Me rastin e shqiptimit të këtij

dënimi gjykata do të marr parasysh po ashtu moshën e të miturit dhe zhvillimin e tij bio-psikik. (Islami, 2003)

Sipas Kodit Penal dhe Kodit të Francës ndaj të miturve nuk mund të shqiptohet dënimi me vdekje, vërejtja e gjykatës e as dënimi me kusht. Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur të Francës gjykata kompetente ndaj të miturit mund të shqiptojë këto masa edukative: masat disiplinore (qortimin gjyqësor), masat e mbikëqyrjes së shtuar (mbikëqyrja e shtuar nga prindi apo kujdestari dhe mbikëqyrja e shtuar nga shërbimet sociale) dhe masat edukative institucionale (dërgimi në institucionin edukativo-korrektues dhe dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm). Se cilën masë edukative do ta shqiptoj gjykata e çështjes varet prej rrethanave që e karakterizojnë të miturin delikuent (mosha, gjendjet shpirtërore, niveli i përgjegjësisë etj.) dhe rrethanat që ndërlidhen me veprën penale (llojin e veprës, peshën e saj, motivet e kryerjes etj (Loeber, R. 1988)

Qortimi mund t'i shqiptohet të miturit që ka kryer vepër penale të lehtë dhe në rrethana lehtësuese, si dhe kur ai nuk është recidivist. Mbikëqyrjen e shtuar nga prindi apo kujdestari gjykata do ta shqiptoj atëherë kur vepra penale është kryer për shkak të lënies pas dore të kujdesit nga ana e prindit apo kujdestarit, dhe kur konstatohet se ata kanë mundësi ta shtojnë mbikëqyrjen e të miturit. Mbikëqyrjen nga ana e shërbimeve sociale gjykata do ta shqiptoj atëherë kur konsideron se ndaj të miturit që ka kryer vepër penale është e nevojshme të ushtrohen shërbimet përkatëse sociale. Kjo masë është e ngjashme me masën edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e organit të kujdestarisë, sepse edhe në rastin e kësaj mase të miturit i caktohet një punëtor social i cili në kontakt të vazhdueshëm me të miturin duhet të siguroj riedukimin e tij, në mënyrë që ai të mos kryej më vepër penale dhe që në të ardhmen të respektoj rregullat e sjelljes në shoqëri. (Islami 2003)

Dërgimin e të miturit në institucionin edukativo-korrektues gjykata do të mund t'ia shqiptoj të miturit që ka kryer vepër penale të rëndë dhe i cili ka nevojë të izolohet nga mjedisi i tij jetësor, si një mundësi për përmirësimin dhe riedukimin e tij. Ndërkaq dërgimi i të miturit në institucionin për kujdes të veçantë gjykata mund t'ia shqiptoj të miturit i cili ka kryer vepër penale, por që ka probleme shëndetësore të natyrës psikike apo fizike. (Artan & Panda, 2003)

2.13.2 Sistemi i sanksioneve penale ndaj të miturve në legjislacionin penal shqiptar

Çështja e sanksioneve penale ndaj të miturve në Republikën e Shqipërisë është trajtuar në Kodin Penal dhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Bazuar në këtë fakt dhe meqenëse Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur do të hyjë në fuqi tek më 1 janar 2018 përmban një sërë risish lidhur me sanksionet penale për të mitur në krahasim me Kodin Penal, e konsideroj të nevojshme që në trajtimet vijuese të pasqyrohen zgjidhet e të dy këtyre kodeve. Ky Kod ka parashikuar se ndaj kryerësve të mitur të veprave penale mund të shqiptohen masat edukative dhe dënimi me burgim për të mitur. Rrjedhimisht në kuadër të masave edukative Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë në pikën 1 paragrafin 3 të nenit 46 ka parashikuar mundësinë e shqiptimit të vetëm një mase edukative ndaj kryerësve të mitur të veprave penale, dhe atë vendosjen e të miturit në një institucion edukimi. *(Kodi Penal të Republikës së Shqipërisë)*

Sipas zgjidhjes së parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni masa edukative mund t'u shqiptohet të miturve në rastet kur ata përjashtohen nga dënimi ose të cilët për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. Në të vërtetë, sipas zgjidhjeve të përcaktuara në këtë Kod të miturit të cilët nuk kanë mbushur moshën 14 vjeçare nuk mund të ndiqen penalisht e të ndëshkohen për krimet që i kanë kryer, miturit që nuk kanë mbushur moshën 16 vjeçare, nuk mund të procedohen e dënohen as edhe për kundërvajtje penale²⁸. *(Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë)*

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur të Republikës së Shqipërisë i cili është në fuqi më 1 janar 2018 përfshin zgjidhje ligjore me natyrë penale material, procedurale dhe të ekzekutimit. Në këtë rast është fjala për zgjidhje specifike që u referohen ekskluzivisht kryerësve të mitur të veprave penale dhe zgjidhje që paraqesin avancim në krahasim me zgjidhjet që i përmban Kodi Penal. *(Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur,)*

2.13.3 Sistemi i sanksioneve penale ndaj të miturve në legjislacionin penal kroat

Sanksionet penale ndaj të miturve në Republikën e Kroacisë janë përcaktuar me Kodin Penal ku përcaktohen edhe sanksionet penale për personat madhor. Sipas këtij Kodi ndaj të miturve mund të shqiptohen këto lloje të sanksioneve penale: masat disiplinore, masat edukative dhe dënimet.

Qëllimi i sanksioneve penale ndaj të miturve është sigurimi i mbrojtjes dhe i ndihmës për të miturit. (Dragan, 2013) Si masa disiplinore të cilat mund t'u shqiptohen të kryerësve të mitur të veprave penale ky Kod ka parashikuar qortimin dhe dërgimin e të miturit në qendrën disiplinore.

Këto masa Kodi në fjalë i trajton si masa edukative. Këto masa mund t'u shqiptohen të miturve në ato raste kur nuk ekziston nevoja për masa afatgjata të edukimit, riedukimit, shërimit apo mbikëqyrjes adekuate (Simović, 2015) Sipas nenit 12 të Kodit Penal të Kroacisë qortimi është masa më e lehtë që mund të shqiptohet ndaj kryerësve të mitur të veprave penale. Këtë masë gjykata e çështjes e shqipton atëherë kur çmon se vetëm qortimi është masë e mjaftueshme për arritjen e qëllimit të masave edukative. “Në këtë rast i bëhet me dije të miturit për dëmin që është shkaktuar nga veprimi i tij i paligjshëm dhe i tërhiqet vërejtja se në rast se përsëritë veprën penale ndaj tij mund të shqiptohet sanksion tjetër penal”. Masën e dërgimit në qendrën disiplinore për të mitur gjykata do ta shqiptoj atëherë kur çmon se ndikimi ndaj personalitetit dhe sjelljes së të miturit është e mundur të bëhet me aplikimin e masave afatshkurtra që vlerësohen edukate për këtë. Në këto raste gjykata e dërgon të miturin në qendrën përkatëse për një numër të caktuar orësh gjatë ditës, që mund të zgjasë nga 14-30 ditë, ose me qëndrim të pandërprerë por në një numër orësh në një kohëzgjatje prej më së shumti 3 muajsh të qëndrimit të pandërprerë në një qendër të tillë. Në qendrën disiplinore i mituri do të angazhohet në kryerjen e punëve që i përgjigjen gjendjes psiko-fizike të tij dhe atij duhet t'i mundësohet vijimi i shkollimit. (Simović 2013)

Krahas kësaj mase gjykata mund të shqiptoj edhe ndonjërin prej masave të mbikëqyrjes së shtuar. Në mesin e masave edukative ligjdhënësi kroat vëmendje të posaçme u ka kushtuar masave të mbikëqyrjes së shtuar. Si masa të tilla ky ligjdhënësi ka parashikuar: mbikëqyrjen e shtuar nga ana e prindit apo kujdestarit dhe mbikëqyrjen e shtuar me qëndrim ditor në një qendër kujdesi. Gjukata do ta shqiptoj masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit apo kujdestarit nëse prindërit apo kujdestari kanë bërë lëshim në edukimin e të miturit, por ata kanë mundësi që ta ushtrojnë një mbikëqyrje të tillë. Në këto raste gjykata mund t'u caktoj disa detyrime të veçanta prindërve ose kujdestarit të cilat do të efektonin në eliminimin e ndikimeve të dëmshme ndaj tij si dhe mund t'u japë udhëzime të caktuara.

Mbikëqyrjen e shtuar me qëndrim ditor në një qendër kujdesi gjykata do t'ia shqiptoj të miturit atëherë kur konstaton se atij i duhet një kujdes i posaçëm profesional me qëllim riedukimi. Kjo masë mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej 3 muaj deri në 3 vjet. Me rastin e shqiptimit të kësaj mase gjykata mund t'ia caktoj të miturit një apo më shumë nga këto detyrime: kompensimin e dëmit personit të dëmtuar, vijimin e rregullt të shkollimit, vijimin e rregullt të punës, aftësimin për ndonjë profesion të caktuar, pranimin e punësimit, mos-shoqërimin me persona të caktuar, mos-vizitimin e lokaleve të caktuara etj. (*Simović, 2013*)

Në mesin e masave edukative ligdhënësi kroat ka paraparë edhe masat edukative institucionale. Si masa të tilla ky ligdhënës ka paraparë: dërgimin e të miturit në entin edukues, dërgimin në shtëpinë edukative-korrektuese dhe dërgimin në entin e posaçëm. Masën e dërgimit të të miturit në entin edukues gjykata do t'ia shqiptoj të miturit ndaj të cilit konsideron se duhet të ushtrohet mbikëqyrje e vazhdueshme nga ana e personave profesionalë, me qëllim të edukimit dhe riedukimit të tyre të drejtë (*Donald J. Newman and Patrick R. Anderson*). Kjo masë nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më të vogël se 6 muaj dhe më shumë se 3 vjet. Është rregull që gjykata më rastin e shqiptimit të kësaj mase nuk e cakton kohëzgjatjen e saj, por ajo caktohet më vonë.

Dërgimin në shtëpinë edukative korrektuese gjykata do ta shqiptoj atëherë kur konstaton se ndaj të miturit duhet të zbatohen masa afatgjate dhe të përforcuara për edukimin dhe riedukimin e tij. Përmes kësaj mase i mituri izolohet nga mjedisi social dhe dërgohet në shtëpinë edukative-korrektuese. Me rastin e shqiptimit të kësaj mase gjykata duhet të marr parasysh peshën e veprës penale të kryer dhe rrethanën nëse ndaj të miturit më herët janë shqiptuar masa edukative ose dënimi me burgim për të mitur. Kjo masë shqiptohet në kohëzgjatje prej 1 deri në 5 vjet. Dërgimin e të miturit në entin për kujdes të posaçëm gjykata do ta shqiptoj atëherë kur të miturit i nevojitet perkujdesje e posaçme për shkak të çrregullimit mendor ose të metave fizike, dhe kur kjo është në interesin më të mirë të të miturve. (*Grisso, T. 1996*)

Qëllimi i kësaj mase është që të evitohen apo zbuten të metat psikike apo fizike në zhvillimin e të miturit. Si rregull, i mituri mbetet në institucionin e tillë derisa është i nevojshëm mjekimi dhe aftësimi i tij. Para shqiptimit të cilësdo nga masat edukative gjykata duhet të marr në konsideratë

cilësitë personale të të miturit, sjelljen e mëhershme të të miturit, rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrethanat në të cilat ka jetuar i mituri etj.

2.14 Faktorët objektiv që ndikojnë në delikuencën e të miturve

2.14.1 Shkaqet ekonomiko – sociale

Ndonëse gjatë trajtimit dhe hulumtimit të kriminalitetit dhe sjelljeve kriminale, shpeshëherë, në shikim të parë fitohet përshtypja se në paraqitjen e tij rëndësi kryesore ka personaliteti i kryerësit dhe veprimit të tij devijant janë rezultat i strukturës dhe vetive të mbrendshme. Në kriminologjinë bashkohore, lidhur me ndikimin e faktorëve objektivë ekonomikë dhe shoqërorë, ka mendime dhe pikëpamje të ndryshme (*Halili, 2007*). Në këtë drejtim theksohet se zhvillimi i hovshëm industrial, të arriturat e mëdha teknike, zhvillimi i elektronikës dhe një vargë transformimesh të mëdha që janë bërë në shoqëri, kanë ndikuar edhe në proceset e formimit të njeriut dhe personalitetit të tij. Të gjitha këto kanë ndikim të caktuar në veprimet dhe sjelljet kriminale. Në vendet e zhvilluara industriale kemi një rritje permanente të standardit dhe një kualitet të lartë të jetesës dhe kushteve materiale, shoqërore dhe kulturore. Ndërsa në vendet e varfëra në vendet të cilat ndodhen proceset e transformimit, dominon varfëria, skamja, dukuritë e ndryshme patologjike dhe kriminaliteti. Gjatë krizave ekonomike shfaqen rënie të ndryshme ekonomike dhe aktivitete kriminale të ndryshme, ku shfaqet mungesa e të mirave materiale dhe ngritja e çmimeve që kalon caqet e mundësive të blerjes nga masat e gjera të popullsisë së shtresave të ulëta. (*Salihu, 2008*)

Këto dukuri formojnë grupe njerëzish në kushte të tilla të pasigurisë me plot rreziqe e pasiguri. Në gjendje të tillë shfaqen apatia, dëshpërimi, kriza personale, protestat dhe konfliktet me sjellje asociale dhe konfliktuoze, të përshtatshme për çfarëdo lloj kriminaliteti për sprovime delikuede. Pra, faktorët objektivë dhe subjektivë kushtëzojnë shfaqjen e aktivitetit kriminal dhe kështu ai shtohet në përmasa të mëdha nga kriza ekonomike të çfarëdo lloji qofshin ato. (*Halili, 2008*)

2.14.1.1 Varfëria, kushtet e vështira të banimit

Ndër faktorët që ndikojnë në rritjen e kriminalitetit është edhe varfëria e cila sipas disa autorëve, është njëri ndër faktorët më “energjik të kriminalitetit”. Varfëria, është njëri ndër faktorët që degradon më së tepërmi njeriun, familjen dhe shoqërinë. Njeriu i varfër shpesh herë ndihet i padobishëm, shpresë humbur, i përbuzur dhe i fyer. Një rrethanë e tillë, e shëndërron atë, shpeshherë në subjekt talljeje dhe fyerjeje nga mjedisi shoqëror, rrethanë kjo që më vonë sjell kundër reagimin fizik i cili mund të çojë edhe deri te vrasjet. Sipas statistikave zyrtare, varfëria si dhe arsimi janë dy faktorët që në çdo rast janë prezent dhe prezentohen nga aktorë të ndryshëm dhe agjenci të ndryshme që merren me hulumtimin e krimit në përgjithsi. (*E. Mezhger, 2011*)

Pra, njerëzit në pamundësi të sigurimit të ekzistencës së tyre dhe familjes së tyre janë të dedikuar të veprojnë dhe shpesh këto veprime të tyre janë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara shoqërore. Si rezultat i kësaj dukurie, sot pothuajse në çdo qytet të botës, janë krijuar paralagjet e të varfërve të cilët janë “burim i kriminalitetit”. Në fakt, gjendja e tyre nuk është për shkak se ata kanë zgjedhur një jetë të tillë, por për shkak se klasa sunduese i’a ka imponuar një gjendje të tillë (*Donald J. Newman and Patrick R. Anderson*). Në një situatë të tillë, varfëria “flirton me krimin” sidomos në veprat penale kundër pasurisë, por nuk përjashtohen edhe vrasjet dhe veprat e tjera penale. Si rezultat i varfërisë është krijuar shtresa e ulët shoqërore, por a janë vetëm të varfërit ata që për shkak të pozitës së tyre sociale prodhojnë krim apo janë edhe të pasurit ata që merren me veprimtari kriminale.

Sigurisht se edhe të pasurit, ata të klasës së lartë shoqërore janë një me krimin, bile me një krim shumë të rrezikshëm që sot në shkencën e kriminologjisë njihet si krimi i jakës së bardhë dhe krimi i organizuar. Varfëria, gjithashtu konsiderohet si një faktor objektiv i kriminaliteti cili ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale. (*Webster, Stratton, C. 1998*) Në literaturën kriminologjike flitet për ndikimin e madh që kanë kushtet e vështira material dhe varfëria në paraqitjen e kriminalitetit. Për ndikimin e madh të skamjes dhe varfëris në paraqitjen e dukurive negative, ka bërë fjalë edhe filozofi antik Aristoteli i cili ka theksuar se “varfëria është nëna e krimit, ndërsa begatia nëna e amoralitetit. (*Ismaili, 2008*). Në këtë drejtim ka edhe mendime të cilat theksojnë se kriminaliteti është product i shtresave të varfëra të popullsisë ndërsa me kriminalitet meren pak shtesat e pasura.

Varfëria edhe skamja mundë të ushtrojnë ndikim në sjelljet dhe qëndrimet e disa individëve sidomos të disa individëve të cilët edhe ashtu janë zhytur në veprime dhe sjellje kriminale. (Webster, Stratton, C. 1998). Nga lakmia për të arritur fitime të mëdha dhe pasuruar shumë persona përfshihen në tregtinë ilegale të narkotikëve. Kjo lloj tregtie motivon edhe persona të tjerë që merren me veprimtari kriminale. Nga ky veprim nuk janë të kursyer shumë bujq që në ngastrat e veta tokësore t'i kultivojnë me shumicë bimën canabis sativa dhe këtë bimë narkotike gjysmë të fabrikuar e shesin në tregjet ilegale, meqë kjo veprimtari paguhet më shumë se sa mbjellja e atyre tokave me kultura të tjera bimore.

Varfëria merret si një prej burimeve kryesore të kriminalitetit ndaj pasurisë duke shkaktuar droje, demoralizim dhe dështim të tyre duke goditur në radhë të parë shumë familje të cilat për këtë shkak bëhen të shqetësuara, të brengosura, jostabile dhe të paafta për një jetë normale. Nga këto familje dalin persona me sjellje devijante, por disa familje edhe pse janë të varfëra e ruajnë dinjitetin e tyre dhe integritetin personal duke mos rënë në kurthe devijante nga varfëria. (Zejneli, 2008)

Ndikimi i faktorit të përmendur shprehet qartë në kuadrin e grupeve shoqërore. dhe të shtresave, që varfëria dhe mjerimi i kanë sjellë në status të ulët shoqëror. Në shtresat e ulëta shoqërore shfaqen shumë dukuri që veprojnë në forma kriminale, siç është edhe tregtia e palejuar e pijeve ose substancave të ndryshme narkotike.

Gjendja e papunësisë, varfëria dhe kushtet e veshtira ekonomike shkaktojnë një apati dhe zhgënjim i cili lidhet me pa perspektivën e zgjidhjes së problemeve të cilat krijohen në familje dhe te individi. Shpeshherë disa individë dhe grupe duke dashur që të dalin nga kjo gjendje e vështirë, fillojnë të merren me aktivitete dhe veprime të dëmshme sociale, si psh. prostitucion, bredhje, lëmoshe, braktisje të familjeve dhe të fëmijëve. (Halili. 2016)

2.14.1.2 Papunësia

Papunësia është e ngjajshme me dukurinë e varfërisë dhe ka të bëjë me pamundësinë e punësimit dhe kyçjes në punë të njerëzve, e kjo sjell mungesën e mjeteve për ekzistencë. Hulumtimet vërtetojnë se papunësia, kushtet e banimit në banesa ku mungon higjiena, sëmundjet e ndryshme kanë bashkëlidhje me kriminalitet dhe bëhen "çerdhe të krimeve", në të cilat shumë persona u nënshtrohen ndikimeve degraduese dhe detyrohen që me hajni, prostitucion, mashtrime e tregti me drogë të kërkojnë burimet e ekzistencës. (*Webster, Stratton, C. 1998*) Duhet të kihet parasysh se këto veprime kriminale mund t'i hasim edhe në vendet e pasura bashkëkohore me një zhvillim të lartë ekonomik dhe me një numër të madh banorësh të punësuar. Personat e papunë nuk cilësohen me karakter të fortë e me veti të tjera pozitive, një pjesë e tyre janë "paraardhës të krimit".

Për këtë në popull thuhet se "papunësia është nëna e të gjitha të këqijave". Çdo shtet që përballohet me këtë dukuri ka dhe do të ketë fluktuacion me lëkundje të mëdha në kriminalitetin e organizuar të shfaqur në forma të ndryshme. Për këtë flet fakti se në mesin e delikuentëve të ndryshëm gjendet një numër i madh me shprehi të këqija siç është marrja e pijeve, të drogave ose pijeve të ndryshme narkotike, të cilët janë të papunë dhe preokupohen vetëm të sigurojnë drogë për dozën ditore.

2.14.1.3 Rrethi familjar dhe kriminaliteti

Familja është mjedisi i parë ku fëmija mëson si duhet të sillet me veten e veçanërisht me të tjerët. Puna adekuate e familjes ndihmon fëmijën që të përmbahet nga dëshirat dhe lakmia e tepërt dhe e pakontrolluar, në mënyrë që sjelljet e tij tëmbahen nën kontroll dhe të mos e dëmtojnë rrethin. Atëherë kur familja nuk e kryesueshëm pjesën e vet të punës, fëmijët me sjelljet e tyre mund të pengojnë të tjerët dhe jo rrallë të bien ndesh me ligjin. (*M. Milutinović, 2008*)

Familja, për ta kryer me sukses misionin e vet të shenjtë në edukimin e fëmijëve, duhet që së pari të jetë e shëndoshë dhe stabile dhetë këtë marrëdhënie të harmonishme ndërmjet të gjithë pjesëtarëve të saj. Përndryshe, familjet me gjendje të vështirë ekonomike, me raporte të çrregulluara ndërmjet bashkëshortëve që përshkohen nga mospajtimet, grindjet dhe tensionet e përditshme si paralajmëruese të divorcit, përbëjnë një ambient të përshtatshëm që fëmijët e tyre të

merren me aktivitete delikvente gjer te format më të rënda. *(Webster, Stratton, C. 1998)* Familja është faktor i pazëvendësueshëm në edukimin e gjeneratës së re. Ajo si kolektiv i vogël i vë bazat fillestare të formimit të personalitetit të fëmijës dhe të edukatës së tij, të cilat shkollës dhe institucioneve të tjera shoqërore u shërbejnë si pikëmbështetje dhe pikënisje për hapat dhe ndikimet e mëtejshme. Në këtë vështrim familja përbën faktorin më të rëndësishëm ndikues në edukimin e fëmijëve, aq më tepër ngase një numër i madh njerëzish prej lindjes deri në vdekje jetojnë në bashkësinë familjare. *(Salihu, 2008)*

Nga të dhënat që janë vjelë në terren, në qendrat sociale, polici e gjykata, mësohet se realiteti për të cilën është studiuar dukuria e delikuencës së të miturve, ende është i ngarkuar me shumë pasoja të mëdha dhe me vështirësi e probleme të tjera që pengojnë funksionimin normal të familjes, sidomos në edukimin e brezit të ri. Ndër to më të ndjeshme janë skamja drastike, papunësia, kushtet e këqija të banimit, humbja e njërit apo të të dy prindërve, ç'rregullimi i marrëdhënieve familjare dhe rritja e numrit të shkurorëzimeve, dobësimi i autoritetit të prindit, braktisja e fëmijëve fill pas lindjes, mungesa e ngrohtësisë emocionale të vatrës shtëpiake dhe e kontrollimit të kohës së lirë të fëmijëve, bashkëpunimi i pamjaftueshëm i familjes me shkollën e me institucionet e tjera që e luftojnë kriminalitetin etj. *(Hajdari, 2012)*.

Të gjitha këto krijojnë një atmosferë dhe terren të përshtatshëm për lulëzimin e delikuencës me të gjitha pasojat negative të saj. Me gjithë këto probleme, vështirësi dhe mangësi, nuk mund të mohohet një pjesë e ndjeshme e përgjegjësisë së familjes për sjelljen delikvente të fëmijëve

Shkolla dhe ambienti shkollor si faktor mikrogrupor Detyra parësore dhe themelore e shkollës gjithmonë ka qenë dhe është ta edukojë, ta arsimojë dhe ta aftësojë brezin e ri për punë dhe jetë normale, e kjo nënkupton edhe kultivimin e sjelljeve të nxënësve në pajtim me kërkesat dhe normat e shoqërisë, të cilave delikuenca u bie ndesh. Shikuar nën këtë prizëm shkolla luan një rol shumëfish të rëndësishëm në parandalimin e kësaj dukurie, e cila në mjaft raste fillon pikërisht aty.

2.14.1.4 Migrimi i populates

Migrimi i popullatës fshat – qytet është përcjellë me ndryshime të mëdha, para së gjithash gjatë përpjekjeve që të arrihet standardi jetësor, i kushteve të jetës së qytetit për shkak të ndërprerjes së shpejtë të lidhjeve jetësore me fqinjët, miqtë dhe lidhjet tjera, si dhe heqja dorë nga ambienti fshatar dhe mënyra e jetesës, shpeshherë nuk janë në gjendje që t'u adaptohen kushteve të reja të jetës, sidomos nuk janë në gjendje që të ndjekin dhe të bashkëveprojnë me ecuritë e reja kulturore, politike, ekonomike, dhe të tjera, si pasojë e gjithë këtyre, paraqitet depresioni emocional dhe urrejtja. *(Latifi, 2007)*

Fluksi i madh i migrimit të popullsisë nga fshatrat në drejtim të qyteteve më të mëdha, që e karakterizon vendin, ka ndikuar në ndryshimin e mënyrës së jetesës së të ardhurve. Jeta më dinamike në qytet sjell ndryshime në raportet njerëzore, në ftohjen dhe individualizimin e marrëdhënieve midis njerëzve. *(Ragipi, 2008)* Migrimi i shpejtuar i banorëve nga fshati në qytet dhe pamundësia e punësimit të sinkronizuar të popullsisë së migruar për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të vendeve të punës në prodhim dhe fuqisë së planifikuar punonjëse, krijojnë probleme të shumta sociale, kulturore dhe edukative.

Mënyra e të jetuarit në qytet ndryshon edhe komunikimin brenda familjes pikërisht për shkak të dinamizmit të jetës, e cila dallon shumë nga fshati, ku njerëzit jetojnë me farefisni, njihen midis tyre, i'a dinë hallet njëri-tjetrit dhe janë më solidarë në ndarjen e së mirës dhe të keqes. Ato janë të lidhura ngushtë me mënyrën sesi janë sistemuar, ambientuar dhe pranuar nga fqinjët në qytet. Edhe pasojat e migrimit nuk janë të njëjta për të gjithë të ardhurit. Ato ndryshojnë varësisht nga ambientimi i tyre në mjedisin e ri. Si vendësit ashtu edhe të ardhurit, dalëngadalë kanë krijuar disa kategori sociale, duke ruajtur gjithnjë një distancë në mes tyre. *(Webster, Stratton, C. 1998)*

2.14.1.5 Mjetet e komunikimit Masiv, ndër faktorët më dominant

Mjetet e komunikimit masiv e posaçërisht shtypi ka rëndës të madhe në bartjen e kulturës tek të miturit. Shtypi i përditshëm ai revial, gazetat e ilustruara dhe zbavitëse shpeshherë me informata të tilla senzacionale, me fotografi dhe ilustrime të rasteve kriminale, sidomos me paraqitjen e

përshkrimeve në detaje të rasteve, ngjarjeve, biografive të personaliteteve të ndryshme, sidomos atyre problematike nga bota e filmit, nga bota e pop dhe rok muzikës, të një kategorie e të miturve nxisin dhe shtytin veprimtari kriminale. (*Stouthamer-Loeber, 2002*). Sot një numër i madh i gazetave të ilustruara, revistave zbavitëse, sidomos atyre me përmbajtje pornografike, video lojrat, internet të cilat gjoja u ofrojnë të miturve mundësi për argëtim dhe për kalim të kohës së lirë, e kanë edhe tirazhin më të madh. (*Halili, 2008*)

Mediat e shkruara dhe elektronike, revistat e ndryshme, librat, filmi dhe teatri janë faktorë edukativ dhe me ndikim pozitiv në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror dhe një indikator që tregon shkallën e emancipimit të një shoqërie të caktuar. (*Halili, 2008*). Por, në anën tjetër, sa i përket fushës për të cilën po flasim, mediat bëjnë pjesë në njërin ndër faktorët do të thoja kryesor në “edukimin kriminal” të opinionit të caktuar me sjellje patologjike. Posaçërisht, viktima të mediave shpeshherë janë të miturit të cilët të frymëzuar nga ndonjë film, ndonjë informacion i nxjerr në televizion apo në shtyp shndërrohet në “aktor” pa gjykuar fare se veprimet e tilla janë të dënueshme. Edhe publikimi i rasteve të caktuara kriminale përmes shtypit, raportimi i drejtëpërdrejtë i rasteve kriminale në televizion, i ndjekjeve të kriminelëve të ndryshëm të cilet bëjnë “heroin” gjatë ikjes nga ndjekja e organeve të rendit (*Stouthamer-Loeber, 2002*)

Mediat elektronike dhe të shkruara kanë rol dhe ndikim të rëndësishëm në delikuencën e të miturve. Ndikimi i tyre si kudo është i pranishëm në çdo vend. Kapaciteti ndikues është i ndryshëm dhe me shumë përmasa, por këtu do të trajtohen vetëm tri dimensione: informues, edukues dhe analitik. Mediat luajnë një rol të rëndësishëm informues për ecurinë, shtrirjen, vëllimin dhe strukturën e delikuencës së të miturve, e kjo paraqet interes si për prindërit ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi për të parë sa janë të rinjtë të "infektuar" nga virusi i kësaj dukurie dhe për të marrë masa të duhura parandaluese e shëruese. (*Ragipi, 2005*)

Jo rrallë mediat janë promotorë dhe gjeneratorë të programeve dhe aktiviteteve të institucioneve të caktuara për luftimin e kësaj dukurie. Kryesisht në shkrime ka dominuar gjuha e prindërve që nuk kanë gjetur kohë të nevojshme, e më së shpeshti nuk kanë pasur mundësi materiale për t'ua plotësuar kërkesat e fëmijëve të cilët kanë filluar me sjellje asociale duke përfunduar në të mitur të dënuar. Në periudhën e përfshirë në këtë kërkim roli konkret i mediave ka qenë aktiv dhe ka

ndikuar pozitivisht në sensibilizimin e opinionit publik dhe të strukturave shtetërore për t'i kushtuar vëmendje më të madhe kësaj dukurie (*Stouthamer-Loeber, 2002*). Informimi dhe aktualizimi i problemit të delikuencës kryen një funksion të rëndësishëm edukues duke rritur ndërgjegjësimin dhe ndjeshmërinë e të gjithë faktorëve përkatës, në radhë të parë të prindërve që të angazhohen më shumë në luftimin e kriminalitetit të të rinjve. Komentet dhe analizat në media, emisionet e drejtpërdrejta, tribunat, tryezat, debatet, etj, përçojnë mesazhe të fuqishme të masat e gjera, familjet, institucionet shtetërore dhe në fund të të gjithë ata që në çfarëdo mënyre mund të ndihmojnë në zbutjen dhe zvogëlimin e intensitetit të kësaj dukurie.

Nëpërmjet analizave e komenteve profesionale jo vetëm njihen natyra dhe shkaqet edukurisë, por mësohen edhe përvojat e përparura të të tjerëve dhe mënyrat se si mund të luftohet me sukses kundër saj. Kureshtja për të parë diçka a për të mësuar ndonjë të fshehtë ose diçka të panjohur, si edhe nevoja për t'u argëtuar dhe për të gjetur prehje nga detyrat dhe brengat e përditshme i ka nxitur të rinjtë e mitur që t'i vizitojnë shpesh dhe gjatë internet kafenetë. Kjo ka ndikuar që ata të largohen nga shkolla e shtëpitë e tyre. (*Herrekohl et al 2001*) Në këto lokale ata mësojnë dhe zhvillojnë aftësitë komunikuese dhe shkathtësitë e tjera, si edhe zbaviten përmes lojërave të shumta të instaluar në programet e internetit, shumica e të cilave kanë karakter luftarak, garues dhe agresiv. S'do mend se koha e gjatë e kaluar në këto lokale lë gjurmë në shpirtin e tyre të brishtë dhe pa mëdyshje ndikon në prirjet e tyre për destruksion.

Të identifikuarit me heronjtë e këtyre lojërave ngjall dëshirën e të riut "për t'u matur" me të tjerët: moshatarë apo më të rritur me bindjen se është më i fortë dhe se e drejta qëndron në anën e tij, kështu që ai fare lehtë mund të kryejë veprime delikuede dhe në bashkëveprim me më të rriturit, edhe ndonjë krim. Për këtë arsye është e nevojshme që prindërit dhe shkollatë ndjekin dhe të kontrollojnë rregullisht ku e kalojnë kohën këta fëmijë kur nuk janë as në shtëpi, as në shkollë, në mënyrë që të parandalojnë infektimin e mundshëm të tyre nga "dhuna" e shfaqur në internet. (*Ragipi, 2005*)

2.14.2 Faktorët subjektiv

Faktorët subjektiv që ndikojnë në delikuencën e të miturve Sado që faktorëve të jashtëm apo objektivë u takon roli determinues në paraqitjen e sjelljeve kriminale në një shoqëri, kriminaliteti dhe shkaqet e tij nuk mund të shpjegohen drejt dhe deri në fund pa analizën dhe ndriçimin e faktorëve të mbrendshëm , subjektivë, të cilët kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit të sjelljeve kriminale. Kur flitet për faktorët subjektivë, zakonisht mendohet për individin, për personalitetin e njeriut, në rastin konkret, të njeriut delikuent (*Herrekohl et al 2001*) Në këtë drejtim, posaçërisht theksohet roli dhe rëndësia e jetës së tij psikike dhe biologjike dhe lidhjet e tij me sjelljet dhe veprimet kriminale. Në literaturën kriminologjike ekziston një bindje e arsishme dhe bukur e përhapur se vetitë psikike dhe biologjike janë komponent me rëndësi vendimtare në jetën e njeriut. Varësisht se si janë zhvilluar dhe si funksionojnë, ato kanë ndikim edhe në sjelljet dhe qëndrimet e njerëzve. (*Salihu, 2010*)

2.14.2.1 Intelejjenca si faktor subjektiv

Intelejjenca është një veti me rëndësi e personalitetit, e cila ka ndikim të madh në sjelljet dhe veprimet e tij në jetën e përditshme. Intelejjenca në psikologji përkufizohet si aftësi e të menduarit, e zgjedhjes së problemeve dhe orientimit në situata të ndryshme, e ndërtimit të koncepteve abstrakte dhe e zgjedhjes së detyrave e problemeve që parashtrihen në jetën konkrete të personalitetit. Mendohet se intelejjenca paraqet një aftësi unike, pra ajo është një tërësi e vetëdijes dhe aftësive të personalitetit. (*Salihu, 2008*)

Sipas psikologut Terry Pettijohn – “Inteligjenca përkufizohet si aftësi për të mësuar dhe për t’u sjellë në mënyrë adoptive” në një ambient të caktuar. (*Halili, 2012*) Nisur nga kjo, është vështirë të thuhet me siguri se personat të cilët janë inteligjentë janë më pak të prirur për të kryer krime ose janë më pak të atakuar nga nxitje të cilat ndikojnë në veprime kriminale. Krimi dhe kriminelët, shikuar sipas tipologjisë së tyre, janë të ndëlidhur mes tyre dhe për të arritur atje ku duan, ata nuk kursejnë asgjë dhe asnjë person me të vetmin qëllim realizimin e përfitimit pasuror ose jo pasuror. Sigurisht se inteligjenca ndihmon në drejtimin dhe aplikimin e metodave të ndryshme

“konvencionale” që lidhen me aftësinë e përdorimit të presionit dhe korrupsionit në raste të caktuara.

Studiues të ndryshëm janë marrë me matjen e inteligjencës së personave të dënuar dhe personave që nuk janë të dënuar dhe sipas tyre, nuk ka ndonjë dallim mes këtyre dy grupeve sa i përket shkallës së inteligjencës. Nga kjo mund të konkludohet se personat e përfshirë në krim në raste të caktuara, falë inteligjencës së tyre arrijnë të fshehin krimin, arrijnë t’iu ikin organeve të rendit duke krijuar edhe spektakle të veçanta dhe në këtë mënyrë arrijnë edhe t’iu shpëtojnë organeve të drejtësisë për një kohë të caktuar (*Grisso, T. 1996*)

Psikologu i njohur amerikan L. Terston përmend shtatë faktorë të intelegjencës: 1. aftësia e të folurit rrjedhshëm dhe gjetja e shprehjeve më adekuate, pra begatia e fjalorit; 2. aftësia e të kuptuarit të përmbajtjeve të formuluar me fjalë; 3. aftësia e të operuarit me numra dhe veprime aritmetikore; 4. aftësia e paraftyrimit dhe të mbajturit në mend të disa proceseve apo ngjarjeve; 5. aftësia e të mbajturit mend e memorjes dhe reproduktimit të përshtypjeve; 6. aftësia e të perceptuarit të hapsirës, sendeve dhe ndryshimeve që ndodhin në ambientin që I rrethon; 7. aftësia e rezonimit apo e përkufizimit, përmbledhjes së raporteve, fakteve, të dhënave të ndryshme, më pak fjalë kjo aftësi mbështetet me shprehjen koncize të përmbajtjeve të cilat janë të gjata. (*Terston, 2008*)

2.14.2.2 Temperamenti si faktor subjektiv

Temperamenti është një veti dhe cilësi me rëndësi psikike për individin, e cila manifestohet në reagimin e tij ndaj ngacmimeve dhe nxitjeve të ndryshme, të jashtme. Disa autorë theksojnë se temperamenti është një veti psikike e personalitetit e cila ka të bëjë me reagimet e tij emocionale, sidomos me intensitetin e reagimeve të tilla. (*Ragipi, 2008*) Të tjerët mendojnë se temperamenti duhet të cilësohet si reagim komplet psikik i njeriut, e jo vetëm si një reagim emocional. Gati pjesa dërmuese angazhohen që si kuptim të temperamentit duhet marrë tërë aktivitetin psikomotorik të individit. Temperamenti nuk paraqet vetëm mënyrat e reagimit psikik, ai nënkupton shpejtësinë dhe zgjatjen e reaksioneve të individit ndaj ngjarjeve dhe ngacmimeve të ambientit i cili e rrethon.

Për këtë arsye, disa autorë, me të drejtë, me nocionin “temperament” nënkuptojnë mobilizimin e energjisë që disponon individi në drejtim të caktuar (*Grisso, T. 1996*)

2.14.2.3 Karakteri si faktor subjektiv

Karakterit është një ndër vetitë kryesore të personalitetit të njeriut. Karakteri konsiderohet si cilësi esenciale e një personaliteti. Në literaturën psikologjike, shpeshherë kuptimi ose nocioni karakter identifikohet me nocionin personalitet. Kësisojë, në të folurit e përditshëm dëgjohej të thuhet për një njeri se ai është “karakter i fortë” ose “karakter i dobët” apo “ai është personalitet i fuqishëm” apo “personalitet stabil” ose “i dobët, labil” etj. Mirëpo, kuptimi ose nocioni karakter, këtu paraqet vetëm një veti psikike të një individi të një personi, e jo individin komplet apo personalitetin e tij.

Megjithëse, kur flitet për karakterin, zakonisht mendohet për vetitë më të qenësishme të individit apo për cilësitë të cilat vulosin tërë aktivitetin njerëzor të tij. (*Salihu 2010*). Duhet thksuar se nocioni i personalitetit ka kuptim më të gjerë se nocioni i karakterit. Me karakter duhet kuptuar para se gjithash, sistemin e tipareve dhe vetive të personalitetit të cilat tregojnë si vepron individi, karshi disa parimeve dhe vlerave morale të shoqërisë së caktuar. Disa individ janë konsekuentë, të vendosur dhe të qëndrueshëm, mirpo nuk kanë qëndrim pozitiv ndaj disa vlerave dhe rregullave morale. (*Grisso, T. 1996*). Ata nuk përputhen me etikën e ambientit të caktuar, nuk përfillin disa rregulla të mirësjelljes apo disa adete dhe zakone të cilat vlerësohen si veti të larta.

Sipas mendimit që mbretëron sot në psikologjinë bashkohore, si cilësi të personalitetit me karakter duhet të konsiderohen ato veti që vihen në lidhje me disa parime etike që vlejnë në një shoqëri dhe të cilat parime vlerësohen si të domosdoshme, normale, të lejuara, të drejta, të dobishme dhe të moralshme. (*Grisso, T. 1996*)

Në këtë drejtim flitet, flitet për vetitë dhe cilësitë si elemente të karakterit të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me moralin dhe etikën por, kanë të bëjnë edhe me vullnetin si dëshirë, si shtytje, të cilën njeriu me karakter është në gjendje të orientojë dhe kontrollojë. Si individ me karakter të fortë cilësohen personat që flasin të vërtetën që e mbrojnë të vërtetën, persona që nuk gënjejnë, persona që nuk u nënshtrohen motiveve dhe interesave të ulta dhe lakmisë materiale. Si persona me karakter konsiderohen edhe personat që janë konsekuentë në qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre për

ndonjë çështje apo për ndonjë problem. Disa autorë si veti dhe tipare të karakterit, përmendin nderin, altruizmin, ndërgjegjshmërinë, vetëbesimin, ndershmërinë, vetëkritikën, konsekuencën, stabilitetin, labilitetin, modestinë, egoizmin, guximin, frikën, sinqeritetin, agresivitetin, këmbëngulsinë dhe veti të tjera. (Salihu, 2010)

2.14.2.4 Çrregullimet mendore si faktorë subjektiv që ndikojnë në realizimin e dukurive kriminale

Në literaturën bashkëkohore kriminologjike, flitet shumë për ndikimin e sëmundjeve të çrregullimeve mendore në sjelljet delikuede të njerëzve. Kur flitet për faktorët individual të sjelljes kriminale, patjetër theksohet nevoja e studimit të rethanave subjektive që kanë të bëjnë me çrregullimet mentale. Problemit të lidhmërisë së të ashtuquajturve sëmundje mendore apo patologjike psikike me sjelljet kriminale, në kriminologji i është kushtuar rëndësi mjaft e madhe. Një kohë të gjatë ka mbretëruar mendimi , sidomos te autorët me orientim dominues psikiatrik, se kriminaliteti është kryekëput rezultat i çrregullimeve dhe patologjisë mentale (Zejneli, 2007) Kësaj hipoteze, deri diku i ka ndihmuar edhe fakti se deri vonë në shkencë nuk është përcaktuar kufiri i qartë në mes të së ashtuquajturës psikologji e shëndoshë dhe psikologji e sëmurë. Mirëpo në shkencën bashkëkohore, në masë të madhe, kjo çështje është zgjidhur.

Tani flitet se ekziston i ashtuquajturi kriminalitet të cilin e kryejnë personat normal dhe kriminalitet të cilin e kryejnë personat me defekte dhe çrregullime mendore. (Grisso, T. 1996) Në literaturën profesionale të psikologjisë kriminale, me të drejtë theksohet se është vështirë të tërhiqet një vijë e qartë përkufizuese në mes të së ashtuquajturës psikologji normale mentale dhe psikologji e sëmurë mentale. Në këtë drejtim, përmenden disa raste kalimtare të personave të cilët vuajnë nga disa ngarkesa dhe defekte mendore, të cilat ndikojnë në sjellje të tyre në shoqëri por edhe në disa veprime kriminale (Zejneli, 2007)

2.14.3 Ndikimi i faktorëve socio-patologjik të kriminalitetit

2.14.3.1 Alkoolizmi

Alkoolizmi është dukuri asociale e cila paraqitet me përdorimin e tepërt të alkoolit, që lë pasoja të rënda, në sferën e shoqërisë dhe në formimin e personalitetit të individit. Alkoolizmi te të miturit krijon situata të tilla që i mundëson personit të mitur lehtë t'u nënshtrohet sjelljeve të ndryshme delikuate. Është dukuri socio-patologjike, që nënkupton konsumimin e tepërt të pijeve alkoolike dhe krijimi i gjendjes së varshmërisë. Konsumimi i alkoolit paraqitet si akut - që mund të jetë e lehtë dhe e rëndë kur konsumohet alkooli në mënyrë jo të rregulltë dhe kronike kur konsumohet alkooli në mënyrë të rregullt në sasi të mëdha dhe sjell varshmërinë e organizmit nga ai. *(Milutinoviq, 1981)*

Alkoolizmi si problem medicinal, paraqet një sëmundje e cila shkatërron shëndetin psikik dhe fizik të individit, te këta persona vërehet dukshëm që zvogëlohet ndjenja e përgjegjësisë ndaj familjes, fëmijëve, dhe rrethit shoqërorë. Paraqet problem të madh në shkaktimin e fatkeqësive në trafik gjatë vozitjes së veturës si të dehur. Sa i përket përhapjes së alkoolizmit në territore të ndryshme, nuk duhet të konsiderohet se kjo dukuri kryesisht është karakteristike vetëm për rrethin urban, por alkoolizmi është prezent edhe tek të miturit në mjediset rurale por në masë më të vogël. Pasojat e alkoolizmit gjithashtu vërehen edhe në komunikacion. Alkooli negativisht ndikon në masë të madhe në aftësitë e vozitësit dhe në koncentrimin e tij. *(Grisso, T. 1996)*

Sipas disa autorëve të shteteve të ndryshme, përqindja e vozitësve të dehur në fatkeqësi automobilistike sillet mbi 50% për këtë arsye në shumë vende në udhëkryqe të mëdha të trafikut përveç shenjave të tjera dhe të mëdha, të theksohet edhe vërejtja dhe porosia për vozitësit “ VOZITËS, NËSE KE PIRË MOS VOZIT, NËSE VOZIT MOS PI “. *(Veseli, 2010)*

Shkenca dhe analizat empirike tregojnë për lidhje në mes të alkoolizmit dhe kriminalitetit. Kështu hulumtimet tregojnë se nën ndikimin e alkoolit si një dukuri e veçantë kryhen veprat penale të vrasjes, lëndimeve të lehta, maltretimeve, kërcënimeve, dhunimeve, veprave penale kundër pasurisë si dhe kundërvajtjeve në komunikacion. Alkoolizmi dhe kriminaliteti kanë ndikim të përbashkët, kështu që alkoolizmi paraqet shkak të drejtpërdrejt për kryerjen e disa veprave penale nga ana e të miturve, dhe veçmas të paraqitjes së përsëritësve të mitur. *(Veseli 2010)* Alkoolizmi

lë pasoja të rënda të personaliteti i individit, kurse pasojat janë më të rënda nëse bëhet fjalë për persona të mitur. Mendohet se sot në botë afër 40 % të aksidenteve në trafikun rrugor shkaktohen nga personat që janë konsumues të alkoolit. (*Grisso, T. 1996*)

2.14.3.2 Prostitucioni

Duke filluar që nga kohërat më të vjetra dhe deri më sot prostitucioni, ka marrë trajtimin e llojllojshëm në shoqëri të caktuar. Thuhet se prostitucioni si dukuri socio-patologjike është i vjetër sa edhe vet shoqëria njerëzore dhe njëherit zanati më i hershëm i shoqërisë njerëzore. Paraqet një sjellje devijante negative e cila çrregullon funksionimin normal të raporteve në mes gjinive në shoqëri. Shumë herët në histori prostitucioni është ndjekur edhe me ligj, kështu 600 – vjet para erës sonë, ligjdhënësi grek Soloni ka tentuar ta rregullojë çështjen e prostitucionit. Ka të bëjë me marrdhënie seksuale në mes femrës dhe një numri të përcaktuar të gjinisë tjetër për qëllime përfitimi. (*T. Markovic, 1973*)

2.14.3.3 Narkomania

Narkomania është term i përgjithshëm që sot shfrytëzohet për të gjitha llojet e varësisë nga drogat e llojllojshme. Sipas WHO-së (Organizatës Shëndetsore Botërore) dhe mendimve të ekspertëve të narkomanisë në vitin 1957, me nocionin narkomani nënkuptohet gjendja e intoksikacionit periodik ose kronik, të shkakuar me futjen e sërishme ose të përhershme të drogës në trup. Shoqërimi i njeriut me drogën ka filluar para shumë mileniunesh respektivisht atëherë kur njeriu ka kuptuar se jeta është e varur nga natyra, dhe se jeta zhvillohet në natyrë dhe është e lidhur me natyrën. (*Zejneli 2007*)

Narkomania paraqet dukurinë negative shoqërore e cila manifestohet në përdorimin dhe konsumimin e drogave dehëse dhe pijeve të tjera narkotike. Ajo shkakton pasojat të rënda për shëndetin psikik dhe fizik të njeriut. Të gjitha drogat dehëse dhe pijet narkotike hyjnë në radhët e materive toksike dhe helmuese që kjo gjendje e varshmërisë nga droga quhet helmim ose toksikomani. Drogat për nga origjina mund të jenë natyrore dhe sintetike. Natyrore janë ato droga që gjenden në natyrë dhe nuk përpunohen dhe fitohen artificialisht ndërsa sintetike e kundërta. Të

gjitha drogat ndahen në: narkotikë, substanca psikotrope apo depresante, pije stimuluese dhe pije narkohalucionogjene. Droga sot nuk paraqet errësirë të panjohur e cila shpejt dhe në mënyrë të depërtueshme thur rrjetën e të rinjve, por njëherazi ajo sotë është sëmundje e tejkalueshme dhe për atë ekzistojnë shumë mundësi të zgjidhjes së drejtë të saj me rrugëdalje të qartë dhe të pastër nga tuneli i errët dhe pa kthim në të. Disa specialistë që meren me problematikën e trafikimit të drogës me të drejtë theksojnë se epidemia e drogës ka fillimin, mesin dhe fundin e saj. (B. Tomovski, 1995)

Në aspektin mjekësor, duke marrë të gjitha masat e duhura për trajtimin e personave që janë përdorues të rregullt të substancave narkotike e psikotrope. Më të njohurat janë: opiumi, morfina, heroina, kanabis, hashash, LSD, meskalina, amfetamina etj

2.14.3.4 Bredhja – ikja nga shtëpia

Bredhja është një dukuri negative shoqërore e cila në shumë raste ka lidhje të ngushtë me sjelljet kriminale. Dukuria e bredhjes qëndron në bredhjen e një kategorie të të miturve, prej një vendi në vendin tjetër. (Salihu, 2008) Është karakteristike se bredhësit kanë një kulturë të veçantë në subkulturë ku dallohen me vlera dhe norma të veçanta të moralit dhe të sjelljes. Ato kanë edhe fjalorin e posaçëm të komunikimit apo zhargonin e tyre të pavarur i cili vështirë kuptohet nga qytetarët të tjerë. Bredhja si dukuri sociopatologjike ka lidhje me disa sjellje kriminale e sidomos me vjedhje, mashtrime, plaçkitje, vrasje, dhunime, etj (Grisso, T. 1996)

Bredhja është fenomen shoqëror negativ i cili manifëstohet në baze të sjelljes së vetë personit të miturit i cili është izoluar nga shoqëria, nga shkolla, nga familja. Kategoria e këtitillë e personave rrjedhin prej familjeve ku konsumohet droga, familje të varfëra ku nuk punon asnjëri nga prindërit, familje problematike, etj. Shumë të mitur të këtyre familjeve të lartpërmendura të adaptuar në kushte të këtitilla të jetës bredhin prej një vendi në tjetrin, prej një shteti në tjetrin. Si zakonisht të miturit që bredhin rrugëve dhe kërkojnë lëmshën janë fare pa përgatitje shkollore apo me ndonjë klasë të mbaruar të shkollës fillore

2.15 REGJIMI JURIDIK I MASAVE DHE DËNIMEVE NDAJ TË MITURVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

2.15.1 MASAT E DIVERSITETIT

Masat e diversitetit janë lloj i masave alternative të cilat mund t'u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale .Këto masa janë parashikuar me akte përkatëse ndërkombëtare (Rregullat e Tokios dhe Rregullat e Pekinit) dhe me legjislacionet penale të një numri të konsiderueshëm të shteteve bashkëkohore. *(Salihu, 2012)* Ato, në fakt, janë masat më të lehta të cilat mund të ju shqiptohen të miturve për të cilët në procedurë penale konstatohet se kanë kryer vepra penale. Në vazhdim të këtij kapitulli do të trajtohen kuptimi, qëllimi dhe çështjet tjera të cilat i karakterizojnë këto masa. 1. Kuptimi i masave të diversitetit Masat e diversitetit janë lloji i masave alternative të cilat parashihen në të drejtën penale bashkëkohore ndaj kryerësve të mitur të veprave penale. Këto masa i parashikon edhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Republikës së Kosovës.

Masat e diversitetit rezultojnë nga Rregullat e Tokios, në të cilat janë paraparë masat dhe sanksionet alternative, si dhe nga Rregullat e Pekinit mbi drejtësinë për të mitur.Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës nuk e bën ndonjë përkufizim të nocionit të masave të diversitetit. Një përkufizim konciz të nocionit të këtyre masave nuk e ka bërë as shkenca e të drejtës penale në Kosovë. Rrjedhimisht, konsideroj se në përcaktimin e nocionit të masave të diversitetit do duhet të merren në konsideratë të gjitha elementet që i karakterizojnë ato. Së këndejmi, sipas mendimit tim masat e diversitetit janë lloj në vete i sanksioneve, përkatësisht masave penale juridike më të lehta të cilat mund t'u shqiptohen të miturve të cilët kanë kryer kryesisht vepra penale të lehta, dhe të cilat konsistojnë në përcaktimin e ndonjë detyrimi konkret ndaj kryerësve të mitur të veprave penale, përmbushja e të cilit mund të efektojë në parandalimin e fillimit të procedurës penale ndaj të miturve, dhe të ndihmojë rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturit në ambientin e tij social, si dhe të parandalojë recidivizmin tek kjo kategori e kryerësve të veprave penale. *(Kodi i Drejtësisë për të mitur, Neni 7)*

Këto masa konsiderohet të jenë inkorporuar në legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore bazuar në njohuritë e shkencës mbi njeriun, sipas të cilave mituria që përfshinë moshën e cila

korrespondon me periudhën e shkollës së mesme, përbën atë stad zhvillimi të personalitetit njerëzor e cila, në krahasim me moshat tjera, është me e trazuar nga ana emocionale dhe shoqërore.

Si specifikë e kësaj moshe është se, adoleshentët janë të pritur për konfliktet me prindërit, mësuesit e tyre etj. Apo siç thotë F. Dolto: “Kjo moshë e vullnetit të pavetëdijshëm dhe e mrekullive të mëdha”,... ose, “Si një kohë e mbushur me re, shi e diell, si një prill befasues që edhe çel gjethin edhe hera-herës të thanë me të ftohtit e zemëruar.”. (*Kodi i Drejtësisë për të mitur*). Por, përfshirja e këtyre masave në legjislacionet penale është edhe rrjedhojë e rekomandimeve që lidhur me to akordojnë Rregullat e Tokios (ku janë parashikuar dënimet dhe sanksionet alternative) dhe Rregullat e Pekinit mbi drejtësinë për të mitur. Këto masa, siç u theksua më lart, janë të përshtatshme të shqiptohen ndaj të miturve që kanë kryer vepra penale të lehta, apo edhe vepra që mund t’i përkasin kriminalitetit të mesëm, por të cilat janë kryer nga pakujdesia. (*Hajdari, 2010*)

2.15.2 LLOJET E MASAVE DHE DËNIMEVE NDAJ TË MITURVE

Kodi i drejtësisë për të mitur parasheh se të miturve të cilët kryejnë vepra penale, mund t’i shqiptohen: Masat dhe dënimet. Mirëpo përveç këtyre ndaj të miturve mund të shqiptohen edhe masat për trajtim të detyrueshëm. Si kriter kryesor në përcaktimin se cili sanksion do të shqiptohet merret për bazë mosha e personit të mitur i cili ka kryer vepër penale. Sipas këtij kriteri nëse i mituri kryen vepër penale në moshën mes 14 dhe 16 vite ndaj tij mund të shqiptohet vetëm ndonjë nga llojet e masave të parapara, ndërkaq për shqiptimin e dënimit si sanksion penale si kriter kryesor merret mosha minimale e përgjegjësisë penal për shqiptimin e këtij sanksioni e cila është 16 vite. (*Kodi Penal i Kosovës, Neni 120*) Pra, sipas këtyre dispozitave personave të mitur nën moshën 16 vite në asnjë rast nuk mund t’i shqiptohet dënimi. Mirëpo si masa të veçanta me karakter mjekësor kodi i drejtësisë për të mitur i parasheh edhe masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat si të tilla janë të ndara nga llojet e sanksioneve penale. (*Kodi i drejtësisë për të mitur, Neni 2, paragrafi 1.3.*)

2.15.3 Masat e zbatueshme ndaj të miturit

Kodi i drejtësisë për të mitur parasheh dy lloje të masave të cilat mund të shqiptohen ndaj të miturit, dhe atë : Masat e diversitetit dhe masat edukuese.

2.15.3.1 Masat e diversitetit

Masat e diversitetit për here të parë në legjislacionin penale të Kosovës janë paraparë në kodin e drejtësisë për të mitur të vitit 2010. Këto masa përfaqësojnë llojin e masave më të lehta të cilat janë të parapara me këtë kod dhe të cilat mund t'u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale. (Salihu, 2010). Sa i përket kohëzgjatjes së tyre ky kod nuk e ka rregulluar në mënyrë taksative këtë aspekt, por e ka lënë në diskrecion të gjykatësit, në mënyrë që në vartësi nga rrethanat e rasti konkrete të vendosë vetë gjykatësi për gjatësinë e shqiptimit të njërën nga këto masa, mirëpo gjykatësi me rastin e shqiptimit të kohëzgjatjes së tyre duhet të ketë parasysh interesin më të mirë të të miturve, dhe duhen të përcaktohen në kohë zgjatje sa më të shkurtër të mundshëm. Ndaj kryerësit të mitur të veprës penale varësisht nga rrethanat e rastit konkret mund të shqiptohen një ose më shumë masa të diversitetit. (Çollaku, 2010)

2.15.3.2 Qëllimin e shqiptimit të masave të diversiteti

Kodi i Drejtësisë për të Mitur e ka përcaktuar në nenin 16 në të cilin përcaktohet “ Qëllimi i masave të diversitetit është që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste” Pra siç shihet edhe nga ky nen dalin disa qëllime kryesore për të cilat shqiptohen këto masa ; - Që ndaj te miturve te mos zhvillohet procedura penale- Të shmangët shqiptimi i sanksionit penale - Të ndikoj ne rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve dhe të shmangë stigmatizimin e të miturve - Pengimin e recidivizmit tek të miturit⁷ Për tu shqiptuar masave të diversitetit, kodi i drejtësisë për të mitur në nenin 17 parasheh dy lloj kushtesh : - Kushti

i parë i cili i referohet veprës penale, dhe - Kushti i dytë i cili i referohet personalitetit të kryerësit të veprës penale. (Salihu, 2010)

Sipas zgjidhjes së kësaj dispozite të dy këto kushte si aj i veprës penale ashtu edhe kushti i cili i referohet personalitetit të kryerësit të veprës penale duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, në mënyrë që ndaj kryerësit të mitur të shqiptohen masat e diversitetit. 1) Kushti i cili i referohet veprës penale përcakton se masat e diversitetit mund të shqiptohen ndaj të miturit i cili ka kryer veprë penale për të cilën është paraparë si dënim kryesor gjoba ose dënimi me burgim deri në 3 vite ose për veprat penale të kryer nga pakujdesia për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në 5 vite, me përjashtim të veprave penale të cilat kanë rezultuar me humbje të jetës së njerëzve. 2) Kushti i dytë mbi bazën e të cilave kryesit të mitur mund t'i shqiptohen masat e diversitetit ka të bëjë me personalitetin e kryerësit të veprës penale. Ky kusht përcakton disa veprimi nga kryerësi i mitur i veprës penale të cilat duhet t'i ndërmarrë në mënyrë që të shqiptohen masat e diversitetit e të cilat kanë të bëjnë me:

- a) Pranimin e përgjegjësisë për veprën penale nga i mituri,
- b) Shprehjen e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar,
- c) Pëlqimin e të miturit ose prindit, prindit adaptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit.

Vetëm pasi i mituri ka plotësuar këto kushte mund t'i shqiptohet një nga llojet e këtyre masave të cilat janë :

- Pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtua, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar,
- Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij,
- Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit,

- Vijimi i rregullt në shkollë,
- Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathhtësitë e tij,
- Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej 10 deri 60 orë, (Hajdari 2012)
- Edukimi me rregullat e trafikut
- Këshillimet psikologjike.

2.15.4 MASAT EDUKATIVE

Në epiqendër të të gjitha llojeve të masave dhe dënimeve që mund të shqiptohen ndaj kryerësve të mitur të veprave penale në Kodin e Drejtësisë për të Mitur të Republikës së Kosovës, janë pikërisht masat edukative. Kjo arsyetohet nga fakti se me këto masa mundësohet që të ushtrohet më mirë rehabilitimi, mbrojtja, ndihma dhe edukimi ndaj të miturve, madje në të shumtën e rasteve pa i izoluar nga mjedisi i tyre social (familja, lagja, shkolla etj.) (Hajdari 2010)

Koncepti dhe qëllimi i këtillë është përcaktuar shprehimisht në nenin 19 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, në të cilin thuhet: “Qëllimi i masës edukative është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste”. (Kodi i drejtësisë për të mitu) Duke pasur parasysh këtë rol, në vazhdim të këtij hulumtimi të disertacionit të doktoratës do të bëhet fjalë për kuptimin e këtyre masave, elementet dhe karakteristikat e tyre, qëllimin dhe llojet e tyre dhe të dhënat ekzistuese lidhur me këto masa. (Kodi i drejtësisë për të mitur Neni 20)

2.15.4.1 Kuptimi i masave edukative

Masat edukative janë lloj i veçantë i sanksioneve penale të cilat mund t’u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale. Ato kanë përparësi në shqiptim në krahasim me çdo sanksion tjetër

penal,¹⁸⁵ dhe ato përjashtojnë aplikimin e dënimit me burgim për të mitur. (Halili, 2014). Këto masa përbëjnë llojin kryesor të sanksioneve penale ndaj të miturve që u shqiptohen kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale, dhe si të tilla gjenden në krye të agjendës së Kodit të Drejtësisë për të Mitur të Republikës së Kosovës. (Salihu, 2010)

Kjo qasje arsyetohet me faktin se me ndihmën e këtyre masave ushtrohet ndikim substancial në rehabilitimin, mbrojtjen, ndihmën dhe edukimin e të miturve delikuent.¹⁸⁷ Masat edukative janë sanksione penale të lehta. Ato paraqesin masat e vetme, krahas masave të diversitetit, që mund t'u shqiptohen të miturve të rinj (14-16 vjeç), dhe sanksione kryesore që preferohet tu shqiptohen të miturve madhor (16-18 vjeç). Si të tilla, kryesisht janë të përshtatshme për ata kryerës të mitur të veprave penale tek të cilët nuk është manifestuar ndonjë shkallë e lartë e devijimit social. Rrjedhimisht, për shkak të karakteristikave që kanë, masat edukative si sanksione penale ndaj të miturve dominojnë jo vetëm në agjendat legjislative, por edhe në punën praktike të gjykatave në Kosovë dhe vendet tjera bashkëkohore. Ky koncept i dominimit ka bazën në përmbajtjen e tyre të përcaktuar me ligj, dhe në rëndësinë që ato kanë në planin e luftimit të kriminalitetit të të miturve, por sidomos në realizimin efikas të procesit të risocializimit dhe riintegritit të të miturve që kanë kryer vepra penale në shoqëri.

2.15.4.2 Elementet e masave edukative

Nga përkufizimi që u është bërë masave edukative rezulton se ato përbëhen nga këto elemente: 1. Vlerësimi negativ nga opinioni i gjerë. Sipas brendisë së tyre masat edukative, si dhe sanksionet tjera penale, paraqesin vlerësim negativ ndaj veprës penale dhe personit që e ka kryer atë.

2.15.4.3 Qëllimi i masave.

Masat edukative kanë si qëllim edukimin, përkatësisht riedukimin e të miturit dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale të tjera; (Elezi, 2010)

2.15.4.4 Kriteret e shqiptimit

Masat edukative mund të shqiptohen vetëm ndaj të miturve që kanë kryer vepër penale dhe që kanë arritur moshën për përgjegjësi penale. Këto masa mund t'u shqiptohen të miturve nga mosha 14-18 vjeçare; Për disa prej këtyre masave ligjdhënësi nuk ka caktuar afat, siç është rasti me qortimin gjyqësor, për të tjerat, afati i kohëzgjatjes së tyre sillet nga 1 muaj (dërgimi në qendrën disiplinore), 2 vjet masat e mbikëqyrjes së shtuar, e deri në 5 vjet (dërgimi në institucionin edukativo-korrektues). 5. Këto masa janë të përcaktuara me ligj. Kjo do të thotë se gjykata mund t'u shqiptoj të miturve që kanë kryer vepra penale vetëm masat edukative të cilat shprehimisht janë paraparë në Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Kjo është në përputhje të plotë me parimin e ligjshmërisë të sublimuar në maksimën e njohur latine “Nulla poena sine lege”. (Elezi, 2010)

2.15.4.5 Karakteristikat e masave educative

Masat edukative si lloje të posaçme të sanksioneve penale manifestojnë disa karakteristika të cilat ato i bëjnë të dallueshme prej dënimeve dhe sanksioneve penale të tjera. Si karakteristika të masave edukative konsiderohen.

1. Organi që i shqipton.
2. Zbatimi i detyrueshëm.
3. Kufizueshmëria e të drejtave dhe lirive themelore.
4. Bazuar në faktin se vendosja e tyre në një institucion nënkupton edhe respektimin e regjimit që ai aplikon në veprimtarinë e tij;
5. Kategoria e kryerësve të veprave penale ndaj të cilëve mund të shqiptohen
6. Karakteri fakultativ i shqiptimit.
7. Mbikëqyrja e zbatimit.
8. Revokueshmëria e vendimit gjyqësor mbi shqiptimin e masës edukative.

9. Mungesa e pasojave juridike.

10. Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë gjithsej tetë masa edukative, të cilat i ka ndarë në masa disiplinore, masa të mbikëqyrjes së shtuar dhe masa institucionale. (*Hajdari, 2012*)

2.15.4.6 Qëllimi i masave edukative

Si çdo lloj tjetër i sanksioneve penale, edhe masat edukative kanë qëllim të caktuar. Qëllimi i masave edukative në aspektin e përgjithshëm është po ai qëllim që në fakt i karakterizon edhe sanksionet tjera penale që u referohen të miturve. Ky qëllim është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti. Megjithatë, si çdo lloj tjetër i sanksioneve penale, edhe masat edukative i karakterizon qëllimi i ashtuquajtur specifik i tyre. Ky qëllim është kontribuimi në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur të veprës penale. Ky qëllim arrihet duke i ofruar mbrojtje të miturit, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke i siguruar atij edukim dhe aftësim profesional si dhe duke ia zhvilluar ndjenjën e përgjegjësisë personale. E gjithë kjo ka si qëllim të fundit që i mituri, pas zbatimit të masës së shqiptuar edukative të fillojë të sillet në përputhje me rregullat ligjore, dhe në instancë të fundit, të evitohet mundësia që ai të shndërrohet në recidivist. (*Revista Shqiptare për Studime, 2006*)

Masat edukative konsiderohen masat themelore në kuadrin e masave dhe dënimeve të zbatueshme ndaj të miturve. (*Hajdari 2010*) Së këndejmi, për arritjen e qëllimit të tyre shtrohet e nevojshme që t'i kushtohet kujdes gjetjes së masës përkatëse edukative me qëllim të mbrojtjes sa më të mirë të të miturve. Kjo qasje mundëson që ata gjatë qëndrimit nëpër institucione të veçanta të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë personale dhe të bëhen qytetar të disiplinuar që respektojnë ligjin dhe normat morale të shoqërisë, e jo të shndërrohen në recidivistë. Për arritjen e këtyre qëllimeve rol të rëndësishëm ka personeli i institucioneve ku bëhet ekzekutimi i këtyre masave.

2.15.4.7 Kohëzgjatja e masave edukative

Në lidhje me kohëzgjatjen e masave edukative ligjdhënësi kosovar ka vendosur dy standarde. 1. Për masa të caktuara siç është rasti me qortimin gjyqësor, Kodi i Drejtësisë për të Mitur nuk përcakton kurrfarë afati. Kjo arsyetohet me faktin se në këtë rast është fjala për masë që ka karakter

të njëkohshëm, tërheqje të vërejtjes për sjellje të keqe dhe për të ndikuar pozitivisht ndaj të miturit që ai në të ardhmen të ketë sjellje të mira. Këtij standardi i përket edhe masa edukative e dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm; 2. Për masat tjera edukative ka përcaktuar limitin e fundit të kohëzgjatjes së tyre. *(Hajdari, 2010)*

Kështu, për masën e dërgimit në qendrën disiplinore është përcaktuar periudha kohore prej më së shumti 1 muaj, me detyrimin që i mituri në atë qendër të qëndroj më së shumti 4 orë në ditë, ose më së shumti 4 ditë gjatë festës shkolllore apo shtetërore, deri në 8 orë në ditë. Për masat e mbikëqyrjes së shtuar limiti më i gjatë kohor i shqiptimit të tyre është deri në 2 vjet. Ndërkaq, për masat edukative institucionale ligjdhënësi ka përcaktuar këto limite kohore të kohëzgjatjes së tyre: 1. Masa e dërgimit në institucionin edukativ mund të shqiptohet në kohëzgjatje deri në 2 vite; 2. Masa e dërgimit në institucionin edukativ korrektues mund të shqiptohet në kohëzgjatje deri në 5 vjet, dhe 3. Masa e dërgimit në institucionin për kujdes të e veçantë, siç u theksua më lart, shqiptohet në kohëzgjatje të pacaktuar, me mundësi revokimi kur pushojnë kushtet që kanë diktuar shqiptimin e saj. *(Kodi I Drejtësisë për të Mitur, 2010)*

Qasja që ka akceptuar ligjdhënësi kosovar në lidhje me përcaktimin e kohëzgjatjes së masave edukative vlerësohet të jetë e drejtë, dhe atë si sa i përket përcaktimit të kohëzgjatjes së tyre, po ashtu edhe sa i përket dallimeve që ka vendosur në kuptim të kohëzgjatjes së afateve për lloje konkrete të këtyre masave. Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Republikës së Kosovës duke përcaktuar vetëm limitet e fundit të kohëzgjatjes së masave edukative ua ka bërë të qartë gjykatave faktin se ato mund t'i shqiptojnë masat e tilla vetëm deri në kohëzgjatjen e specifikuar. Në këtë rast, atyre u është lënë mundësia që në varësi të vlerësimit që i bëjnë rastit konkret, të shqiptojnë atë kohëzgjatje që e vlerësojnë të jetë e mjaftueshme për arritjen e qëllimit të këtyre masave, por vetëm deri në kufirin e fundit të parashikuar për kohëzgjatjen e tyre. *(Leka, 2014).*

Rrjedhimisht, ligjdhënësi kosovar u ka dhënë autorizime gjykatave që, në varësi të suksesit të arritur, të revokojë masat e shqiptuara edhe para se të ketë kaluar koha për të cilën ato janë shqiptuar. Sidoqoftë, me Kodin e Drejtësisë për të Mitur është parashikuar se kohëzgjatja e masës edukative në asnjë rast nuk duhet të kalojë afatin maksimal të dënimit me burgim të paraparë për veprën penale. Kështu, nëse dënimi me burgim për veprën penale për të cilën akuzohet një i mitur

është parashikuar dënimi me burgim deri në një vit, atij masa edukative e dërgimit në institucionin edukativ nuk mund të kalojë këtë kohëzgjatje (1 vit) (*Kodi I Drejtësisë për të mitur*)

Sipas zgjidhjeve të përcaktuara në këto dispozita ligjore gjykata kompetente ndaj kryerësve të mitur të veprave penale mund të shqiptoj këto lloje të masave: qortimin gjyqësor, dërgimin në qendrën disiplinore; mbikëqyrjen e shtuar nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari; mbikëqyrjen e shtuar nga familja tjetër; mbikëqyrjen e shtuar nga organi i kujdestarisë, dërgimin në institucionin edukativ, dërgimin në institucionin edukativ korrektues dhe dërgimin në institucionin për kujdes të posaçëm. Këto lloje të masave edukative, bazuar në kriteret e vendosura për shqiptimin e tyre dhe karakteristikat specifike që ato përfaqësojnë, ligjdhënësi kosovar i ka sistemuar në tri grupe themelore: masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat institucionale. Kështu, në kuadër të masave disiplinore janë përfshirë: 1. Qortimi gjyqësor, dhe 2. Dërgimi në qendrën disiplinore;

Në kuadër të masave të mbikëqyrjes së shtuar janë përfshirë: 1. Mbikëqyrja e shtuar nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari; 2. Mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër, dhe 3. Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë. Ndërkaq, në kuadër të masave institucionale janë përfshirë:

1. Dërgimi në institucionin edukativ;
2. Dërgimi në institucionin edukativ-korrektues, dhe
3. Dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm.

Dy grupet e para të masave edukative, masat disiplinore dhe masat e mbikëqyrjes së shtuar, ekzekutohen në liri. Ndërsa masat institucionale ekzekutohen duke e veçuar të miturin nga mjedisi i tij i mëparshëm familjar dhe social, duke e vendosur në institucionet e caktuara edukative. Së këndejmi, për shkak të natyrës dhe qëllimit të tyre, me masat institucionale kryerësit të mitur të veprës penale i merret liria e lëvizjes. (*Kodi I Drejtësisë për të Mitur*)

2.15.5 Masat disiplinore

Masat disiplinore shqiptohen kur gjykata konstaton se ndaj kryerësit të mitur të veprës penale mund të arrihet efekti i edukimit me masa afatshkurtra, veçanërisht nëse vepra është kryer nga pamaturia apo pakujdesia. *(Salihu, 2004)* Këtu është fjala zakonisht për të miturit të cilët kryejnë vepra penale për shkak të mungesës së përgjegjësisë personale për veprimet e tyre të cilët nuk është zhvilluar ndjenja për domosdonë e respektimit të disiplinës shoqërore. *(Elezi, 2010)*

Zbatimi i këtyre masave supozon se delikuenti i mitur jeton në mjedisin shoqëror i cili i bën të mundshëm zhvillim dhe edukim të drejtë, kështu që nuk është e domosdoshme të shqiptohet ajo masë edukative e cila do ta ndante të miturin nga mjedisi ku jeton. Veçmas sërish po theksojmë se këto masa do të shqiptohen nëse gjykata konstaton se nuk është e nevojshme të shqiptohen masa edukative afatgjata *(KDM Neni 20)* Edhe pse ligdhënësi nuk e thekson, këto masa edukative mund të shqiptohen vetëm në rastet e kryerjes së veprave penale të lehta dhe kur te i mituri nuk është manifestuar nivel i lartë i devijimit të tij në aspektin edukativ e social.

Në situata të tilla, gjykata gjithnjë duhet të orientohet drejt masave apo sanksioneve tjera, të cilat vlerësohen më të përshtatshme për riedukimin dhe risocializimin e të miturit. Me Kodin e Drejtësisë për të Mitur të Republikës së Kosovës parashihen dy lloje të masave disiplinore të cilat gjykata mund t'ua shqiptoj kryerësve të mitur të veprave penale. Këto masa janë: qortimi gjyqësor dhe dërgimi në qendrën disiplinore. *(Salihu, 2010)*

2.15.6 Masat institucionale

Masat institucionale janë lloji më i rëndë i masave edukative. Me masa institucionale kryerësi i mitur i veprës penale privohet nga liria dhe vendoset në institucione të posaçme të edukimit dhe

rehabilitimit. Këto masa u shqiptohen të miturve ndaj të cilëve duhet ndërmarrë masa më afatgjata me qëllim të edukimit, riedukimit dhe trajtimit, mjekimit të tyre, si dhe në rastet kur është i domosdoshëm veçimi i tyre nga mjedisi ku jetojnë. (Salihu, 2008) Për shqiptimin e masave edukative institucionale duhet të plotësohen dy kushte:

- Ekzistimi i nevojës ë domosdoshme që ndaj delikuentit të mitur të ndërmerren masa afatgjata të edukimit, riedukimit apo mjekimit.

Kjo nevojë determinohet nga fakti se këtu është fjala për ata të mitur të cilët është manifestuar shkallë e lartë e devijimit në edukimin e tyre, rrethanë kjo që tregon se edukimi dhe zhvillimi i drejtë i tyre nuk mund të realizohet me aplikimin e masave edukative afatshkurtra. Në fakt, këtu zakonisht është fjala për të mitur të cilëve më parë u janë shqiptuar masa tjera edukative, por të cilat nuk kanë dhënë efekte të duhura; (Salihu, 2008)

2. Mjedisi social ku ka jetuar i mituri të ketë ushtruar ndikim të dëmshëm në sjelljet e të miturit.

Ky fakt determinon nevojën që ky ndikim negativ të eliminohet. Që kjo të ndodhë i mituri duhet të ndahet (izolohet) për një kohë relativisht të gjatë nga ai mjedis. Këto dy kushte për shqiptimin e masave edukative institucionale, në mbështetje të rekomandimeve të Rregullave të Pekinit mbi Drejtësinë për të Mitur i ka akceptuar edhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Republikës së Kosovës. Ky Kod në paragrafin 4 të nenit 20 të tij përcakton se gjykata i shqipton këto masa në rastet kur konstaton se është i nevojshëm veçimi afatgjatë i të miturit nga mjedisi i mëparshëm, me qëllim që të miturit t'i ofrohet mundësia e edukimit, riedukimit dhe trajtimit. Për shqiptimin e këtyre masave këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Ndërkaq se cila masë edukative institucionale do të shqiptohet në rastin konkret varet nga vlerësimi që ua bën gjykata interesave më të mira të të miturit. (Maloku, 2012)

Meqenëse është fjala për masa që mision të tyre kanë edukimin dhe riedukimin e mjekimin e të miturit është më se e qartë se institucionet ku bëhet ekzekutimi i tyre duhet t'i plotësojnë një sërë kushtesh të karakterit teknik, organizativ e profesional. Në ato institucione duhet të ketë profesionist të aftësuar (edukatorë, psikologë, punëtor social, mjekë etj.), programe konkrete dhe të avancuara të riedukimit dhe trajtimit dhe kapacitete teknike që mundësojnë arritjen e qëllimeve

të përcaktuara. “Me rastin e shqiptimit të këtyre masave gjykata duhet të formojë bindje se është e nevojshme që i mituri të veçohet nga mjedisi i mëparshëm, ngase pa veçimin e tij nuk do të ishte e mundur ta arrihet riedukimi, trajtimi dhe zhvillimi i drejtë”. Është rregull parimor i akceptuar nga Rregullat e Pekinit mbi Drejtësinë për të Mitur se para shqiptimit të masave edukative institucionale gjykata duhet të ketë parasysh dy kufizime të rëndësishme. Kufizimi i parë ka të bëjë me atë se shqiptimi i masave të tilla përmes të cilave veçohet i mituri nga mjedisi i tij i mëparshëm duhet të jetë mjet i fundit, dhe atë pasi të jenë shterur të gjitha mundësitë tjera.

Kjo do të thotë se ndaj të miturit delikuent paraprakisht duhet të zbatohen të gjitha llojet tjera të masave edukative që janë më të lehta, ose dhe kur vlerësohet se në rastin konkret nuk është e mundur të zbatohet masa tjetër. Kufizimi i dytë lidhur me masat edukative institucionale konsiston në faktin se këto masa duhet të shqiptohen për një afat kohor sa më të shkurtër të mundshëm. Në paragrafin 4 të nenit 20 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur janë parashikuar tri lloje të masave edukative institucionale: dërgimi në institucionin edukativ, dërgimi në institucionin edukativo-korrektues dhe dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm. (*Kodit i Drejtësisë për të Mitur*)

Vlen të theksohet fakti se, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 7 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur kur gjykata e shqipton masën e dërgimit në institucionin edukativ apo atë të dërgimit në institucionin edukativo-korrektues në kohëzgjatje deri në 2 vjet, ajo mund të pezulloj ekzekutimin e tyre dhe të shqiptojë dënimin me kusht në pajtim me kriteret e përcaktuara në Kodin Penal të Kosovës. (*Kodi Penal I Republikës së Kosovës*)

2.16 DËNIMET NDAJ TË MITURVE

Siç është theksuar më lart, masat e diversitetit dhe masat edukative janë sanksionet penale kryesore të cilat në të shumtën e rasteve u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale. Mirëpo, meqenëse një luftë e suksesshme kundër kriminalitetit të të miturve nuk është e mundur vetëm përmes shqiptimit të këtyre masave, në shkencën e të drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore është formësuar bindja për domosdonë e shqiptimit edhe të dënimeve ndaj të miturve. (*Grisso, T. 1996*)

Në këtë aspekt sidomos ka ndikuar fakti i përsëritjes së veprave penale nga një numër i caktuar i të miturve ndaj të cilëve më parë janë shqiptuar masat e diversitetit dhe ato edukative, por edhe fakti se te disa të mitur është fjala për shkallë të atillë të devijimeve në edukim, e cila kërkon medoemos trajtim afatgjatë dhe intensiv për edukimin dhe riedukimin e tyre. Përveç kësaj, për t'u realizuar preventiva gjenerale dhe speciale kundër kriminalitetit, imponohet domosdoja që në disa raste ndaj kryerësve të mitur të veprave penale të reagohej me ato sanksione penale të cilat janë më të rrepta se masat edukative dhe të cilat kanë karakter të dënimit. Për këto dhe arsye të tjera me Kodin e Drejtësisë për të Mitur është paraparë mundësia që ndaj kryerësve të mitur të veprave penale të shqiptohen edhe dënimet. *(Ukaj, 2014)*

Në vazhdim të këtij kapitulli, do të flitet për kuptimin e dënimeve ndaj të miturve, elementet, karakteristikat, qëllimet dhe llojet e tyre. 1. Kuptimi i dënimeve ndaj të miturve Marrë në përgjithësi, dënimi është sanksion penal të cilin e shqipton gjykata pas zhvillimit të procedurës së përcaktuar me ligj, ndaj kryerësve të veprave penale penalisht të përgjegjshëm dhe të fajshëm me qëllim të luftimit të kriminalitetit, mbrojtjes së vlerave më vitale të njeriut dhe shoqërisë në tërësi, i cili konsiston në marrjen ose kufizimin e të drejtave të caktuara kryerësit të veprës penale për veprën penale të kryer. Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Republikës së Kosovës nuk e përcakton kuptimin e dënimit. *(Stojanović 2003)*

2.16.1 Elementet e dënimeve ndaj të miturve

Elementet e dënimeve ndaj të miturve kanë burimin në nocionin e dënimit. Këto elemente nuk kanë ndonjë dallim nga elementet e dënimeve në përgjithësi.

Rrjedhimisht, si elemente të dënimeve ndaj të miturve konsiderohen:

1. Sipas brendinë së tij, dënimi paraqet vlerësim negativ moral - etik ndaj veprës penale dhe kryerësit.

2. Dënimet duhet të jenë rrjedhojë e veprës penale të kryer.
3. Dënimet duhet të jenë të përcaktuara me ligj.
4. Dënimet kanë qëllim të caktuar.
5. Dënimet mund t'u shqiptohen vetëm kryerësve të përgjegjshëm të veprave penale. –
6. Dënimet mund t'i shqiptoj vetëm gjykata sipas procedurës së përcaktuar me ligj

Elementet e lartcekura të dënimeve ndaj të miturve janë të natyrës konstituive. Kjo do të thotë se në mungesë të vetëm njërit prej tyre nuk mund të ketë dënim në kuptimin e mirëfilltë të së drejtës penale. Nga kjo rezulton se pa përjashtim çdo dënim duhet doemos t/i posedoj të gjitha elementet e lartcekura.

2.16.2 Karakteristikat e dënimeve ndaj të miturve

Duke u nisur nga elementet konstitutive dhe efektet e dënimit, në teorinë e së drejtës penale janë përcaktuar edhe disa karakteristika, apo tipare që duhet të përmbushen me rastin e shqiptimit dhe zbatimit të tij. Këto tipare themelore të dënimit përgjithësisht, dhe të dënimeve ndaj të miturve konsistojnë në sa vijon:

1. Dënimi duhet të jetë personal. - Kjo do të thotë se dënimi përgjithësisht, si dhe në raport me të miturin duhet të godasë vetëm kryerësin e veprës penale, por jo edhe personat tjerë. Kështu, dënimet që mund t'i shqiptohen kryerësit të mitur të veprës penale nuk mund të godasin prindërit e tij. Kështu, p.sh., dënimi me gjobë mund t'i shqiptohet të miturit vetëm nëse ai ka pasuri të vetën. Pra ai nuk mund të godasë pasurin e prindit të tij. (*Hajdari, 2012*)
2. Dënimi duhet të jetë human. - Kjo do të thotë se dënimi nuk guxon të paraqet mundim apo përbuzje të delikuentit të mitur, si dhe nuk guxon të dëmtojë shëndetin e tij. (*Salihu, 2008*)
3. Dënimi duhet të jetë legjitim. - Dënimi është legjitim vetëm nëse gjykata e shqipton atë lloj dhe lartësi të dënimit, i cili është i domosdoshëm për arritjen e qëllimit të tij të përcaktuar me ligj. “Lidhur me këtë është mjaft impresiv konstatimi vijues: “Një represion që nuk është i preokupuar

me risocializimin e delikuentit bën një punë të kotë dhe johumane”. Kështu, nëse dënimet shqiptohen në kuptim të hakmarrjes e urrejtjes ndaj delikuentit, atëherë ato dënime nuk janë legjitime, dhe në brendinë e tyre janë edhe kundërligjore”.(Salihu, 2008)

4. Dënimi duhet t’i godasë njësoj kryerësit e mitur të veprave penale. - Ky tipar i dënimit, në fakt konsiston në realizimin e parimit të barazisë së qytetarëve para ligjit e gjykatës, dhe në realizimin e politikës ndëshkuese unike.

5. Dënimi duhet të jetë i ndarë. - Dënimi është i ndarë nëse ai mund të shqiptohet në masën më të vogël apo më të madhe, varësisht nga pesha e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer, rrezikshmërisë së kryerësit, interesit më të mirë të të miturit dhe kërkesave për zhvillim të drejtë të tij. (Salihu 2008)

6. Dënimi duhet të jetë i revokueshëm. - Dënimi është i revokueshëm atëherë kur ai, në rast se është shqiptuar në kundërshtim me ligjin, për shkak të lajthimeve të gjykatës apo provave të rrejshme, mund të abrogohet.

Në Kodin e Drejtësisë për të Mitur ka shumë zgjidhje ligjore që adresojnë çështjen e revokimit të sanksioneve penale për të mitur, përfshirë në mënyrë të veçantë dënimet.

7. Dënimi duhet të jetë i përmirësueshëm.- Dënimi është i përmirësueshëm atëherë kur ai, në rast se është marrë në kundërshtim me ligjin apo për shkak të lajthimeve të gjykatës apo provave të rrejshme, mund të përmirësohet. Kodi i Drejtësisë për të Mitur përmban shumë zgjidhje që mundësojnë përmirësimin e dënimeve ndaj të miturve, dhe atë sidomos dënimit me gjobë, burgim por edhe të dënimeve të tjera.

2.17 Dënimet plotësuese, dhe Masat e trajtimit të detyrueshëm.

Në vazhdim të këtij kapitulli do të flitet veç e veç për secilin prej këtyre llojeve të dënimeve e masave të posaçme të cilat mund tu shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale. Trajtimi i këtyre çështjeve, përveç pasqyrimeve teorike do të shtrihet edhe në dimensionin praktik.

2.17.1 Dënimi me gjobë

Dënimi me gjobë është dënim i karakterit pasuror i cili konsiston në vendosjen e detyrimit të kryerësit të veprës penale që brenda një afati të caktuar të paguaj një shumë të hollash në llogari të shtetit. (Salihu, 2012) Në mesin e dënimeve kryesore, dënimi me gjobë përfaqëson lloj të lehtë të dënimeve. Dënimi me gjobë është veçanërisht i përshtatshëm për rastet e kryerjes së veprave penale të lehta, mirëpo në mënyrë restriktive mund të zbatohet edhe në rastin e kriminalitetit të mesëm. Dënimi me gjobë është duke u shqiptuar në përmasa të larta veçanërisht në vendet e zhvilluara ekonomikisht. Kështu, sipas të dhënave statistikore, nga i tërë numri i dënimeve të shqiptuara, dënimi me gjobë në Francë është shqiptuar në 32% të rasteve, në Finlandë 67%, Danimarkë 75%, Suedi 68%, Austri 70%, Gjermani më tepër se 80% etj. 291 Dënimi me gjobë përbën njërin prej dënimeve i cili, përveç ndaj madhorëve, mund të shqiptohet edhe ndaj kryerësve të mitur të veprave penale”. (Grisso, T. 1996)

Ky lloj dënimi ndaj të miturve ka filluar të masovizohet pas vitit 1980. Në atë kohë është konstatuar se është e paarsyeshme që ky lloj i dënimit pasuror të mos aplikohet edhe për rastet e delikuentëve të mitur të cilët kanë të ardhurat e tyre ose posedojnë pasuri nga e cila mund të paguajnë gjobën. Dënimin me gjobë për të mitur e parashohin edhe Rregullat e Pekinit”. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). Duke u mbështetur në trendët bashkëkohore të trajtimit penalo-juridik të delikuentëve të mitur dhe në veçanti në Rregullat e Pekinit, edhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Republikës së Kosovës e parasheh dënimin me gjobë. Ky Kod në zgjidhjet e tij i parasheh kushtet mbi bazën e të cilave ky lloj dënimi mund t’u shqiptohet kryerësve të mitur të veprave penale. Rrjedhimisht, konform paragrafit 3 të nenit 7 dhe paragrafit 1 të nenit 30 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë gjykata duhet të marrë parasysh: Moshën e kryerësit të mitur të veprës penale. - Dënimi me gjobë mund t’i shqiptohet vetëm të miturit që ka mbushur moshën 16 vjeçare. (Halili, 2008)

2.17.2 Matja e dënimit me gjobë për të mitur

Për matjen e dënimit me gjobë të shqiptuar ndaj të miturit vlejnë rregulla të caktuara. Këto rregulla janë të karakterit të përgjithshëm, të posaçëm, dhe të atilla që i referohen matjes së këtij dënimi për rastet e kryerjes së veprave penale në bashkim (*Kabashi 2011*)

2.17.3 Urdhri për punë në dobi të përgjithshme

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme është lloji i dytë i dënimeve i cili mund t'u shqiptohet kryerësve të mitur të veprave penale që është paraparë në Kodin e Drejtësisë për të Mitur. (*Salihu 2008*) Përmes këtij lloji të dënimit, konform trendëve bashkëkohore, është bërë një hap i rëndësishëm në humanizimin e të drejtës penale. Është kështu sepse ky lloj dënimi nuk e izolon kryerësin e veprës penale, nuk ia merr atij lirinë e lëvizjes. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme është dënim i karakterit subsidiar, është zëvendësim i dënimit me burgim apo me gjobë. “Përkatësisht, qëllimi i dënimit për punë në dobi të përgjithshme është që kryerësi të veprës penale, në vend se të dënohet me burgim apo me gjobë, t'i caktohet detyrimi që brenda afatit të caktuar të kryej një punë në interes të përgjithshëm pa pagesë. (*Kodi I Drejtësisë për të mitur*)

Në Kosovë puna në dobi të përgjithshme për kryerësit e mitur të veprave penale ka filluar të aplikohet në vitin 2000. “Ky lloj dënimi fillimisht është shqiptuar nga gjykatat e Mitrovicës në bashkëpunim me organizatën joqeveritare Terr de zom (Terres des hommes). Urdhrin për punë në dobi të përgjithshme gjykata e shqipton me vendim të posaçëm. Në këto raste ajo mund ta urdhërojë të miturin që të kryej punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një afat të caktuar prej 30 deri në 120 orë.

2.17.4 Burgimi për të mitur

Burgimi për të mitur është lloji më i rëndë i dënimit i cili mund t'u shqiptohet kryerësve të mitur të veprave penale. Me këtë lloj dënimi të miturit i merret liria e lëvizjes. Burgimi për të mitur mund të shqiptohet vetëm përjashtimisht dhe për llojet e veprave penale shumë të rënda dhe nëse plotësohen kushtet të cilat janë paraparë në mënyrë taksative në Kodin e Drejtësisë për të Mitur.³ (*Hajdari, 2012*). Rrjedhimisht, konform nenit 33 të këtij Kodi gjykata mund të shqiptojë dënimin

me burgim për të mitur vetëm nëse konstaton plotësimin e këtyre kushteve: 1. Kryerësi i veprës penale të jetë i mitur i rritur (16-18 vjeç); 2. Kryerësi i mitur i veprës penale duhet të ketë qenë i përgjegjshëm për veprën në kohën e kryerjes së saj, 3. Vepra penale e kryer nga i mituri duhet të jetë e dënueshme me dënim me burgim mbi 5 vjet; 4. Vepra penale e kryer të ketë shkaktuar pasoja shumë të rënda, të cilat të ndërlidhura me nivelin e përgjegjësisë së kryerësit të mitur nuk do të ishte adekuate të shqiptohet masë edukative apo ndonjë lloj tjetër i dënimit. Për të mundur të shqiptohet dënimi me burgim për të mitur këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. *(Aktgjykimin PM. nr. 5/2014 të Gjykatës Themelore në Prizren)*

Në kuadër të këtyre kushteve, për shkak të specifikave të personalitetit të të miturit, të cilat dukshëm dallojnë nga personat madhorë, çështja e përgjegjësisë së të miturit duhet të shpjegohet më hollësisht. Siç rezulton nga kushti i fundit, burgimi për të mitur është dënim subsidiar, që do të thotë se shqiptimi i tij është gjithëherë fakultativ. Kjo do të thotë se kur janë përmbushur kushtet e sipërpërmendura, gjykata mundet, por nuk është e obliguar, të shqiptojë burgimin për të mitur.

Me rastin e shqiptimit të burgimit për të mitur gjykata duhet të ketë në konsideratë nevojën e arritjes së qëllimit të tij. Kjo do të thotë se gjykata do të mund ta shqiptojë këtë lloj dënimi vetëm atëherë kur konsideron se kjo është mundësia e vetme që vlerësohet e përshtatshme për riedukimin e të miturit. Se çka është qëllim i burgimit për të mitur përcaktohet në nenin 32 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur. *(Kodit të Drejtësisë për të Mitur)*

Përveç kësaj, burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për të parandaluar recidivizmin” Minimumi i kohëzgjatjes prej 6 muajve të burgimit për të mitur konsiderohet i domosdoshëm që të mund të ndërmerren masat përkatëse për edukimin, riedukimin dhe aftësimin profesional. Ndërsa maksimumi i përgjithshëm i kohëzgjatjes prej 10 vjetësh është masa më e lartë e këtij lloji dënimi me të cilin konsiderohet se mund të arrihet qëllimi i burgimit për të mitur për rastet shumë të rënda të veprave penale dhe shkallës së lartë të devijimit të të miturit. Lidhur me maksimumin më të lartë të burgimit për të mitur deri në 10 vjet, duhet të theksohet se me të para së gjithash shprehet funksioni i preventivës gjenerale i këtij dënimi, ngase edukimi dhe rehabilitimi i të miturit nuk kërkon një kohëzgjatje kaq të lartë. *317 (Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës)*

Me rastin e matjes së dënimit me burgim për të mitur, gjykata është e kushtëzuar nga maksimumi i dënimit i cili është i paraparë për atë veprë penale. Andaj, dënimi me burgim për të miturit nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më të lartë se dënimi me burgim i paraparë për atë veprë penale.

Minimumi i posaçëm i paraparë për veprën penale të caktuar, nuk e obligon gjykatën me rastin e matjes së burgimit për të mitur. Kështu, p.sh., nëse për veprën penale të kryer është paraparë minimumi i dënimit me burgim prej pesë vjetësh, të miturit për atë veprë mund t'i shqiptohet burgimi për të mitur në kohëzgjatje më të shkurtër se pesë vjet, por jo më pak se 6 muaj.

2.18 Dënimet plotësuese ndaj të miturve

Dënimet plotësuese janë lloje të posaçme të sanksioneve penale të cilat u paraqitën si rezultat i njohurive se dënimet kryesore nuk mund të jenë të vetmet mjete efikase ndaj të gjithë kryerësve të mitur të veprave penale. Për këtë arsye në të drejtën penale u formësua mendimi se, krahas dënimit duhet paraparë edhe sanksione të tjera penale të karakterit komplementar, plotësues, me të cilat do të bëhej i mundshëm parandalimi më efektiv i kriminalitetit të të miturve dhe risocializimi i të miturve të dënuar më burgim. *(Kodi Penal i Kosovës)* Dënimet plotësuese janë dënime specifike që në shumë aspekte dallohen nga dënimet kryesore dhe alternative. Këto dënime janë konstruktuar në atë mënyrë që të mund të shqiptohen vetëm krahas dënimeve kryesore, me përjashtim të dënimit me gjobë i cili mund të shqiptohet edhe si i vetëm por edhe krahas dënimit me burgim. *(Salihu, 2012)*

Me nenin 62 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës janë paraparë nëntë dënime plotësuese të cilat mund t'u shqiptohen kryerësve të veprave penale. Këto dënime janë: heqja e të drejtës për t'u zgjedhur; urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit; ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike dhe në shërbimin publik; ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës; ndalimi i drejtimit të automjetit, marrja e lejes së vozitjes, konfiskimi, urdhri për publikimin e aktgjykimit, dhe dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës. *(Kodi Penal I Kosovës)*

Mbështetur në konceptin mbi të cilin është ndërtuar Kodi i Drejtësisë për të Mitur, e sidomos duke marrë parasysh personalitetin e të miturit dhe natyrën, qëllimet dhe esencën e dënimeve plotësuese, konsideroj se gjykatat e Kosovës mund t'u shqiptojnë të miturve vetëm këto katër lloje të dënimeve plotësuese:

1. Ndalimin e drejtimit të automjetit;
2. Marrjen e sendit;
3. Urdhrin për kompensimin e humbjes apo dëmit,
4. Dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht, për të mundur gjykata të shqiptojë njërin nga katër llojet e dënimeve plotësuese kryerësit të mitur të veprës penale duhet të plotësohen këto kushte:

1. Kryerësi i veprës penale të jetë i mitur i rritur (16-18 vjeç);
2. Kryerësi i mitur i veprës penale duhet të ketë qenë i përgjegjshëm për veprën në kohën e kryerjes së saj
3. Gjykata duhet të miturit t'i ketë shqiptuar njërin nga tri llojet e dënimeve për të mitur (gjobën, punën në dobi të përgjithshme, burgimin për të mitur)

3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Qëllimi i këtij punimi të disertacionit të doktoratës është të dëshmojë se sanksionet penale ndaj të miturve janë mjete të rëndësishme në duart e organeve kompetente e të shoqërisë kosovare për të luftuar kriminalitetin e të miturve dhe për të mbrojtur vlerat vitale të individit dhe shoqërisë. Në fakt, përmes këtij hulumtimi bëhet përpjekje modeste për të vënë në dukje rëndësinë që kanë sanksionet penale për të mitur për të rikthyer të miturit delikuent në rrugën e drejtë të zhvillimit dhe perspektivës dhe për të parandaluar shndërrimin e tyre në recidivist. Sanksionet penale ndaj të miturve manifestojnë efekte të shumta dhe të llojllojshme. Këto efekte kryesisht përqendrohen në:

Parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit; Mbrojtjen e përshtatshme të lirive dhe të drejtave të njeriut; Kthimin e suksesshëm të delikuentëve të mitur në shoqëri, të riedukuar dhe të aftë për t'u përballur me sfidat e kohës; Jetësimin e qëllimit të sanksioneve penale; Jetësimin e barazisë së qytetarëve para ligjit; Respektimin e dinjitetit dhe personalitetit të njeriut; Jetësimin e parimit të ligjshmërisë etj

4 METODOLOGJIA

Pikënisje për studimin e sanksioneve penale ndaj të miturve ka qenë metoda e materializmit dialektik. Përmes zbatimit të kësaj metode është arritur në përfundim se sanksionet penale ndaj të miturve nuk janë shfaqur rastësisht në shoqëri, porse të njëjtat e kanë rrugëtimin e tyre të zhvillimit që nga e kaluara më e hershme e deri në ditët e sotme. Në studimin e sanksioneve penale ndaj të miturve kam përdorur edhe metodën juridike- dogmatike. Përmes kësaj metode kam arritur të përcaktoj kuptimin e sanksioneve penale ndaj të miturve, llojet e tyre, specifikat, funksionet dhe qëllimet e tyre të përfshira në zgjidhjet ligjore përkatëse. Kjo metodë më ka mundësuar që të

analizoj sanksionet penale ndaj të miturve gjatë fazave të caktuara të zhvillimit të shoqërisë kosovare, de lege lata, ashtu siç ishin përcaktuar me dispozitat juridike penale të kohës, dhe de lege ferenda, ashtu siç duhet të jenë. Përveç kësaj studimit të sanksioneve penale ndaj të miturve i jam qasur duke përdorur edhe metodën historike. Përmes kësaj metode është arritur të studiohen sanksionet penale ndaj të miturve në një periudhë të gjatë të zhvillimit të shoqërisë kosovare, përfshirë mënyrën e rregullimit të tyre në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Ligjin Penal të Kosovës dhe Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës. Me ndihmën e kësaj metode është bërë i mundur studimi dhe hulumtimi shkencor i sanksioneve penale ndaj të miturve në Republikën e Kosovës, të vështruara si dukuri shoqërore dinamike të cilat i kanë kushtëzuar kushtet dhe rrethanat e caktuara shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, historike, morale, fetare si dhe kushte e rrethana të tjera. Duke u bazuar në këtë metodë studimi është arritur të kuptohet se sanksionet penale ndaj të miturve janë jo vetëm dukuri juridike, por ato janë edhe dukuri shoqërore, të cilat ishin dhe janë të pranishme në çdo kohë, sepse ato u shqiptuan dhe u shqiptohen çdo ditë kryerësve të mitur të veprave penale dhe ato paraqesin mjete të domosdoshme për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti. Për hulumtimin e këtij punimi të doktoratës kam përdorur edhe metodën statistikore. Me ndihmën e kësaj metode është prezantuar vëllimi dhe dinamika e shqiptimit të llojeve të sanksioneve penale ndaj të miturve dhe kohëzgjatja e tyre gjatë periudhës kohore 2008-2016.. Gjatë përgatitjes së këtij punimi kam përdorur literaturë të gjerë shkencore e profesionale të botuar në Kosovë, Shqipëri, në Evropë dhe botë.

5 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në legjislacionin penal të Kosovës një vëmendje e veçantë i kushtohet trajtimi i të miturve në konflikt me ligjin. Një ligj i veçantë "Kodi i Drejtësisë për të Mitur" u miratua në 2010, dispozitat e tij rregullojnë të gjithë çështjet në lidhje me çështjen e drejtësisë për të miturit. Kodi i Drejtësisë rregullon trajtimin e të miturve si shkelës, të miturve si pjesëmarrës në procedura, të cilat bazohen në respektimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore dhe në dritën e pjekurisë së të miturit, niveli i tyre të zhvillimit, shkallën e veprës së tyre dhe specifikat personale dhe aftësi, në mënyrë që të ndihmojë në procesin e rehabilitimit të tyre dhe riintegrimi në shoqëri.

Kodi i Drejtësisë përcakton sanksionet që mund të vendosen të miturve në konflikt me ligjin. Në këtë letër, disa nga kryesore janë trajtuar çështje në lidhje me këto masa, siç janë: karakteristikat e këtyre masave, individët mbi të cilët mund të jenë këto masa imponuar, kushtet që duhet të përmbushen përmes zbatimit të këto masa, llojet e këtyre masave, organet përgjegjëse për zbatimin dhe zbatimin e këtyre masave, dhe procedurën e tyre aplikacion. Punimi përmban të dhëna statistikore për zbatimin e këto masa dhe llojet e masave të zbatuara nga gjykatat në Kosova.

Në aspektin legjislativ, Kosova ka bërë një progres të rëndësishëm kur me miratimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur ka bërë ligjore kodifikimi në një ligj të vetëm me të cilin ka rregulluar të gjithë drejtësinë istemi për të miturit, duke rregulluar të gjithë procedurën për të miturit duke filluar nga paraqitja e tyre në polici deri në ekzekutimin e sanksioneve të tyre. Sidoqoftë, në kërkesë konkretisht në ekzekutimin e sanksionet po përballlet me probleme të ndryshme të cilat krijojnë vështirësi në arritjen e efekteve dhe synimin e të njëjtave.

Mungesa e stafit profesional, ose numri i vogël i të njëjtit në institucionet përkatëse që janë kompetente për zbatimin dhe ekzekutimi i këtyre sanksioneve, duket të jetë më mbizotëruesi problem. Për shembull, një raport nga Prokuroria e Shtetit zbulon numër i lartë i aktakuzave me të cilat duhet të merret një prokuror i vetëm..

Mungesa e objekteve infrastrukturore për ekzekutimin e kriminelëve sanksionet ndaj të miturve është një tjetër pengesë. Aktualisht, ekziston vetëm një qendra korrektuese ku mbahen të miturit e dënuar dhe ekzekutimi i masës edukative bëhet në të njëjtën qendër e cila ka një ndikim shumë negativ te të miturit pasi mungesa e kategorizimit në këtë qendër bën që kontaktet e të miturve me individë me e kaluara kriminale shfaqet si një problem serioz. Prandaj është e para rëndësia për të kategorizuar këtë Qendër Korrektuese vetëm për një kategori të shkelësve të veprës penale (vetëm për të miturit e paraburgosur ose të paraburgosurit). Funkcionalizimi i objekteve për ekzekutimin e masës edukative për të miturit është një çështje që paraqet një rëndësi paraprake. Ndarja e të miturit femrat nga gratë e rritura të dënuara duhet gjithashtu të zhvillohen.

Për më tepër, duhet kushtuar më shumë vëmendje në zbatimin e masave edukative, nuk duhet të ketë masa të dyfishta e vendosur për dy vepra të ndryshme, në një rast gjykata kishte vendosur një masë e re pa ekzekutuar e para.

6 REFERENCAT

- Zejneli, Ismail; E drejta penale-pjesa e posaçme, Tetovë, 2008, fq. 80
- Halili, Ragip; Kriminologjia, Prishtinë 2008, fq.22
- Latifi, Vesel; Kriminalistika e delikuencës së të miturve, Prishtine, 1984
- Kambovski, Vllado; E drejta penale-pjesa e përgjithshme, përkthim, Shkup, 2006
- Kambovski, Vllado; E drejta penale-pjesa e përgjithshme, përkthim, Shkup, 2006, f. 596
- Kodi Penal I R. Maqedonisë, Shkup, 1996
- Arafati, Shaban; Psikologjia e sjelljeve sociale, Tema Delikuenca e të miturve

- Kriminaliteti i të Miturve në Shqipëri, përgatitur nga Qendra për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), Tiranë, 2007.
- A, Dida, Patologjia shoqërore e të miturve në Kosovë, fq.59
- Z, Ismail, Delikuenca e të miturve në RM, fq. 21,22
- Nasufi, Dashmir; Delikuenca e të Miturve në R. Maqedonise, Strugë.2016
- Latifi, Vesel, E drejta, Prishtinë, 1997, faqe, 28
- Ligji mbi drejtësinë për të mitur i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së”, nr.143/13
- Ismail. Z, Delikuenca e të miturve në RM, f. 27-28.
- H. Ragip, Kriminologjia, fq. 224.
- Ismail Z, Delikuenca e të miturve në RM, f. 30
- Zejneli, ismail; Delikuenca e të miturve në RM, fq. 31
- Ragipi, Halil; Kriminologjia me penologji, fq. 421
- Shih nenin 46 dhe 51 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995.
- I qasshëm në: <http://www.qbz.gov.al/Kode--2014.pdf>. Shfletuar më: 05.02.2017.
- Islami, Halim & Hoxha, Artan & Panda, Ilir. Procedura penale - Komentar, Tiranë, 2003, fq. 596
- M.Millatonoviq; vepra e cituar fq. 375-376 37
- Halili,Ragip; Kriminologjia; Prishtinë 2008 fq. 273
- Zejneli, Ismail: Delikuenca e te miturve, Tetove 2018, fq.128
- Halili, Ragip; Kriminologjia, Prishtinë, 2006, fq.231
- M. Milutinović, vepra e cituar, fq. 388-399

- Latifi, Vesel & Halili Ragip; Kriminalitetit i të rinjve në Kosovë, Prishtinë, fq. 244
- Halili, Ragip; Kriminologjia, Prishtinë, 2005 fq. 264
- Halili, Ragip; Kriminologjia, Prishtinë 2000
- M, Milutinović, Kriminologjia, Beograd, 1981, fq.373
- Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, f. 193.
- Grup autorësh, Kriminaliteti i organizuar, Tetovë, 2009, f.184.
- Halili, Ragip; Viktimologjia, Prishtinë 2007, fq.97
- Bistra Netkova- Ismail Zejneli; Trafikimi me njerëz aspektet juridike< Tetovë, 2007. fq.21
- B. Tomovski; Droga semundje e se sotmes, Shkup, 1995, fq.10
- Zejneli Ismail; Delikuenca e te miturve, Tetovë, 2018.fq 160
- Azem Hajdari, Sistemi i Drejtësis për të mitur, Prishtinë, 2010, f. 47
- Kodi i Drejtësis për të mitur, Neni 7, paragrafi 3
- Kodi i drejtësisë për të mitur, Neni 28
- Liridon Maloku, Ekzekutimi i masave edukative,, Revista shkencore “Justica”, nr,1/2012, Prishtinë, 2012, f.337
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18019>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>